

KALLARATI



Ec ngado,
Kallaratin mos e harro!

ORGAN PERIODIK I SHOQATËS K / A "KALLARATI"
Viti i 20-të i botimit, **nr. 116**, korrik- shtator 2025
Çmimi 50 L, Websajt: www.kallarati.com;

E-mail: gazetakallarati@yahoo.it
Kryeredaktor: Lefter **Hysaj**
Ky numër u sponsortizua nga:
Robert Mehmetaj



ÇETA E KALLARATIT NË LUFTËN E VLORËS 1920

Me rastin e 105-vjetorit të Luftës së Vlorës, kujtojmë me nderim kontributin e fshatit tonë, Kallarait, përmes çetës vullnetare të tij, e cila përbëhej nga këta luftëtarë: Bilbil Haxhiu, Binjar Lulo, Boro Ribi, Dalan Haxhiu, Daut Veizi, Dino Matjani, Ethem Boshi, Feim Çelo, Ferat Halo, Feti Xhelo, Habip Gjoni, Halil Haxhiu, Hasan Shamo, Hodo Kalemi, Hyso Fega, Islam Emmini, Kadri Azemi, Kajtaž Bejko, Lame Sinani, Lelo Jazo, Leven Boro, Maman Boçi, Manxhar Mezini, Mečan Selami, Mečan Strati, Memush Balili...

Faqe 2



ANDON BEGAJ ZËRI I GJALLË I KËNGËS LABE



Faqe 9

25 GUSHT 1943 - 25 GUSHT 2025 82 VJETORI KRIJIMIT TË ORGANIZATËS SË GRUAS ANTIFASHISTE NË KALLARAT



Faqe 3

KALLARATI
NË AKSIONET
KOMBËTARE PËR
RINDËRTIMIN
E VENDIT TË
SHKATËRRUAR
NGA LUFTA,
NGA VITI 1946
E NË VIJIM

Në këtë shkrim kthejmë sytë pas në vitet e para të Shqipërisë së lirë, kur vendi ynë, i dalë nga lufta shkatërrimtare, kishte nevojë të shëronte plagët dhe të hidhte themelet e një shteti të ri. Ishin vitet kur fjala aksion u bë simbol i rinisë dhe i popullit, ndërsa vullnetarizmi u kthye në mjetin kryesor për të rindërtuar vendin dhe për të ngritur veprat e para industriale e rrugore...

Faqe 4

SI U ARRIT TË
REALIZOHEJ PERLA
FOLKLORIKE
"JANINËS Ç'I
PANË SYTË"

Faqe 10

ÇETA E KALLARATIT NË LUFTËN E VLORËS 1920

- Me rastin e 105 vjetorit të luftës së Vlorës -

Me rastin e 105-vjetorit të Luftës së Vlorës, kujtojmë me nderim kontributin e fshatit tonë, Kallaratis, përmes çetës vullnetare të tij, e cila përbëhej nga këta luftëtarë: Bilbil Haxhiu, Binjar Lulo, Boro Ribi, Dalan Haxhiu, Daut Veizi, Dino Matjani, Ethem Boshi, Feim Çelo, Ferat Halo, Feti Xhelo, Habip Gjoni,

Halil Haxhiu, Hasan Shamo, Hodo Kalemi, Hyso Fega, Islam Emini, Kadri Azemi, Kajtaž Bejko, Lame Sinani, Lelo Jazo, Leven Boro, Maman Boçi, Manxhar Mezini, Meçan Selami, Meçan Strati, Memush Balili, Meto Laçaj, Miftar Dauti, Ramadan Rjepi, Sali Asllani, Selam Bajrami, Shaban Dauti, Shamo Meçe, Tasim Janji, Telha Duro, Veip Balili, Veip Xhaferi, Veliko Murati, Xhemil Xhelo, Xhevair Gollosi, Xhezo Zhibi, Zigur Ademi, Ziflo Alushi. Komandant: Feim Çelo (Strati); zëvendës komandant: Habip Gjoni; nëtarë të shtabit: Lame Sinani, Hodo Kalemi, Meçan Selami.

Në fillim të kryengritjes çeta qëndroi në rezervë, por shumë shpejt iu bashkua betejave më të mëdha:

11 qershor 1920: u përfshi në mësymjen e përgjithshme, në sektorin Uji i Ftohtë – Kaninë, krah çetave të Dukatit, Gumenicës, Bolenës, Kaninës e Rrëzës. 19 qershor 1920: luftoi me trimëri në thyerjen e kundërgoditjes italiane pranë përroit të Kallafetit. 23 korrik 1920: mori pjesë në mësymjen e dytë, në drejtimin Qishbardhë – Mali i Vreshave – Mesovun. Në këto beteja, Kallarati dha edhe gjakun e vet: U vra Xhevair Gollosi, 20 vjeç, sot “Dëshmor i Atdheut”, dhe u plagos luftëtari Veip Balili.



Ky është kontributi i çmuar i Kallaratis, një dëshmi krenarie e sakrifice për lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë.

Lavdi përjetë Çetës së Kallaratis dhe luftëtarëve të Luftës së Vlorës!

Lavdi dëshmorit Xhevair Gollosi dhe gjithë

dëshmorëve të kësaj epopeje!

(Shfrytëzuar libri “Enciklopedia e Kurveleshit” dhe drafti i Historikut të Kallaratis)

JEHONA E LUFTËS SË VLORËS.

- Me rastin e 105 vjetorit të luftës së Vlorës -

Pjesë nga një korrespondencë nga Vlorë me rastin e hyrjes në qytet të forcave çlirimtare shqiptare, 3 shtator 1920.

Më 3 të vjeshtës së parë, ditë e premte, mbledhur nga tërë viset e Shqipërisë në qytetin e bukur të Vlorës, po përgatiteshin që të gjithë për pritjen e luftëtarëve luanë, të cilët ishin mbledhur në Drashovicë.

Në krye të bulevardit ishte ngritur një piramidë e lartë e veshur me të zeza, të kuqe dhe të bardha, ku shkruhej me shkronja të arta: Këtu janë shpirtrat e dëshmorëve që ranë në fushën e nderit dhe që shpëtuan Vlorën nga thonjtë e armiqve. Cili qe ai njeri që pa me sy gjithë këto dhe nuk derdhi lot të nxehtë? Dhe nuk iu ngritën leshrat përjetë?

Ora arriti. Të parat hynë një shumicë karrocash me të plagosurit të veshur me rroba të spitalit dhe mbuluar me flamurë kombëtarë. Të plagosurve u shkëlqente fytyra nga gëzimi dhe ishin fare të padëshpëruar për plagët që kishin marrë në fushën e nderit. Ata thërrisnin: Rroftë Vlorë, rroftë Shqipëria. Dhe tani le të vdesim porsa ia arritëm kësaj dite. Në orën 9 e 30 vërshojnë luftëtarët me flamuj në duar. Mbi 10 mijë qytetarë brohoritën në kor “Rrofshin, rrofshin luftëtarët” dhe lotët nga të dy palët po derdheshin lumë. Në këtë minutë shumë të dëgjojmë zërat e bandës së Elbasanit “Afërdita”, e cila udhëhiqte fitimtarët. Pastaj banda kombëtare “Vatra” zuri të buçasë marshin e pritjes dhe populli thërriste “Rroftë banda”.

Merr fjalën kryekatundari me një talent të bukur dhe thotë: Të dashur vëllezër! Sot po festojmë ditën më të bukur të jetës sonë. Vlorë, e cila ishte në një rrezik të madh, u çlirua nga këta heronj, pastaj, iu drejtua luftëtarëve: Ju po i jepni një jetë të re Vlorës dhe gjithë Shqipërisë. Rrofshi



sa malet, pra or burra, or luanë. Rroftë Shqipëria! Merr fjalën profesor Jani Minga, i cili, si një orator i shkëlqyer që është, e përfundon fjalimin: Vlorë vdes dhe kurrë nuk duron zgjedhë. Rroftë Vlorë e Shqipërisë! Rroftë Shqipëria!

Pastaj Jani Minga ngre sytë përjetë dhe duke i mbërthyer në majë të piramidës, tha: “O varr i

shenjtë, ti që përmbledh shpirtrat e dëshmorëve tanë, që ranë në fushë të kësaj lufte, mbaji me kujdes. Dhe ti, o Zot, dërgo balsamin në zemrat e atyre nënave, baballarëve, motrave dhe farefisit të tyre dhe lehtësoua hidhërimet e shpirtit”.

Pas fjalë së profesorit u zhvillua ceremonia e dëshmorëve, ku banda këndoi himnin funeral.

Tërë dita dhe nata e 3 shtatorit kaloi me këngë, valle, drita e fishekzjarre.

(Shkëputur nga një shkrim me të njëjtin titull, shkruar nga Gafur Shametaj (ndarë nga jeta) me rastin 92 vjetorit të luftës së Vlorës), botuar në gazetën Kallarati, Nr. 63

25 GUSHT 1943 – 25 GUSHT 2025

82 VJETORI KRIJIMIT TË ORGANIZATËS SË GRUAS ANTIFASHISTE NË KALLARAT

Gratë e Kallaratis, si të gjitha gratë e Labërisë, jo vetëm në punë, po edhe në luftëra për mbrojtjen e trojeve nga sulmet e të huajve kanë qëndruar përkrah burrave të fshatit. Këtë e tregojnë edhe vargjet e një kënge:

*“Kallarati fshat i paktë,
trima burrat, trime gratë,
Që të shqyejnë me sëpatë”.*

Kështu ndodhi edhe në luftën e vitit 1914 kundër sulmeve të bandave shoviniste greke, por edhe më masivisht e më të organizuara gratë e Kallaratis u gjendën përkrah burrave, vëllezërve e djemve të tyre edhe në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në këtë luftë gratë e fshatit tonë krijuan organizatën e tyre antifashiste, si mbështetëse dhe kontribuese me pjesëmarrje aktive në çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj. Ato, që me nisjen e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, fillimisht prisnin e strehonin në vatrat e tyre ilegalët, veprimtarët e Lëvizjes dhe në vazhdim, luftëtarët e lirisë, partizanët e çetave, grupeve e brigadave të Ushtrisë nacionalçlirimtare, të cilëve u shërbenin me të gjitha mundësitë që kishin, duke ndarë me ta edhe kafshatën e bukës së fëmijëve të tyre.

Organizata e Gruas u krijua më 25 gusht të vitit 1943 në shtëpinë e patriotes Duze Bajramaj, biri i së cilës, Mumini, ishte një nga të parët kundërshtarë të vendosur të pushtimit fashist dhe dëshmor i parë i fshatit e i krahinës që bëri jetën fli për çlirimin e atdheut. U mblodhën në atë shtëpi gratë më aktive në mbështetjen e luftës çlirimtare dhe vendosën krijimin e organizatës së tyre antifashiste. Pasi folën e diskutuan për luftën që po bëhej për çlirimin e vendit nga pushtuesit, për kontributin që po jepte Kallarat, për gjakun që po derdhej dhe për detyrat që u dilnin grave kallaratase, si gjithë grave shqiptare, në mbështetje të LANÇ, u kalua në zgjedhjen e këshillit (kryesisë) që do të drejtonte organizatën. Në këshill u zgjodhën 7 gra: Duze Barjamaj, Pashako Petanaj, Meno Qejvanaj, Shaze Hitaj (Meçaj), Xhevo Jonuzaj, Hyri Memushaj, Tefo Karabollaj. Kryetare e këshillit u zgjodh Shaze Hitaj. Pas saj, në detyrën e kryetares së këshillit të grave janë zgjedhur, njëra pas tjetrës, Meno Qejvanaj e Xhevo Jonuzaj.

Detyrën e saj organizata e gruas antifashiste në Kallarat e kreu me nder e lavdi, duke përballuar një peshë jo të vogël gjatë gjithë luftës dhe pas çlirimit në rindërtimin e fshatit dhe rimëkëmbjen e ekonomisë. Ajo zhvilloi një veprimtari të gjerë propagandistike me gratë për mbështetjen e luftës çlirimtare, për aktivizimin e tyre në ndihmë të partizanëve me ç` të kishin mundësi: ushqime, veshje të ndryshme si triko, çorape etj. Me mbledhjet e saj të dendura, organizata u hapi horizont dhe i emancipoi gratë e fshatit edhe për çlirimin e tyre nga zakonet prapanike e paragjykimet fetare etj, nga ndrydhja dhe



inferioriteti para burrave për hir të zakonit ekzistues, për zhdukjen e zakoneve të vjetra të lidhjes së krushqive me mblesëri etj.

Dhe jo vetëm kaq, nga radhët e tyre, sidomos nga ato më të reja, pa u ndrojtur nga propaganda keqdashëse ndaj pjesëmarrjes së femrave në luftë, disa nuse e vajza hodhën pushkën krahut dhe u rreshtuan në formacionet partizane, duke luftuar kundër pushtuesve njëllor si meshkujt. Të tilla ishin Qamile Goxhaj, Salto Golloshaj, Trëndafilë Breshanaj, Zonjë Memushaj, Lalo Qejvanaj e Sano Muharremaj.

Gratë e Kallaratis përballuan me moral të lartë të gjitha operacionet ushtarake ndëshkimore të pushtuesve në krahinën tonë edhe kur ato shpesh ndodheshin vetëm me fëmijët nga që meshkujt

ishin rreshtuar në formacione partizane apo ishin të angazhuar në aksione të ndryshme, si pjesëtarë të çetës territoriale.

Një nga vajzat kallaratase, Belere Boshaj, gjatë operacionit të parë të forcave fashiste italiane në prill 1943, duke u ndodhur me banim të përkohshëm në Horë të Vranishtit, ajo në mbrojtje të nderit të saj dhe nga urrejtja që kish për pushtuesit, me guxim rrëmbeu sëpatën dhe vrau me të një oficer italian që iu fut në kasolle dhe u përpoq ta kapte vajzën, ndërkohë që u vra edhe vetë ajo nga një ushtar fashist që shoqëronte oficerin.

Ndërsa Duze Bajramaj, nëna e dëshmorit të parë të fshatit, Mumin Selamit, pavarësisht nga pikëllimi i papërshtatshëm për Muminin dhe që më

pas mori edhe lajmin tjetër të kobshëm se edhe djali i madh i saj në Egjipt ishte ndarë nga jeta nga një epidemi tifoje dhe megjithëse e moshuar dhe e vetme në shtëpi, përmbloodhi forcat dhe u bë një agjitatore dhe veprimtare e flaktë e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke e shndërruar shtëpinë e saj në bazë të luftës çlirimtare.

Ajo priste e përcillte luftëtarët e lirisë deri edhe partizanë të plagosur, siç ishte rasti i partizanit të çetës së Rinisë të Qarkut të Gjirokastrës, Jonuz Galanxhi të plagosur rëndë në një ndeshje me nazistët gjermanë gjatë operacionit të dimrit të vitit 1943. Duzja i shërbeu atij me të gjitha mundësitë, sikur të ishte djali i saj duke e ushqyer e mjekuar me barna popullore (mëllaga etj.) disa ditë me radhë, por ai ishte në kllapi dhe nuk mundi t`i mbijetonte dot plumbit që kish marrë në bark. Kur vdiq, ajo e qau me lotë dhe me ndihmën e bashkëfshatarëve e varrosi pas shtëpisë së saj derisa pas çlirimit të vendit erdhën njerëzit e tij dhe e tërhoqën trupin.

Duzja deklaronte: “Do luftoj me të gjitha forcat për të vënë në vend amanetin e djalit tim e të djemve të tjerë të nënave”. Me aktivitetin e saj, ajo u bë e njohur jo vetëm në krahinën e Kurveleshit e të Mesaplikut dhe në qarkun e Gjirokastrës, por edhe më gjerë. Pas çlirimit Duzja për kontributin e dhënë në luftë meritoi zgjedhjen deputete e Kuvendit Popullor nga populli i Lumit të Vlorës dhe i Kurveleshit të Poshtëm. Organizata e Gruas në Kallarat ka ekzistuar edhe pas çlirimit, si të gjitha organizatat e tjera shoqërore, duke luajtur një rol të rëndësishëm të jetës shoqërore e kulturore në fshat, biles edhe në vitet e demokracisë, në një kohë që shumë organizata të tjera shoqërore kanë pushuar së ekzistuari.

Vlerësim e mirënjohje gjithë nënave e motrave tona që në kohë e periudha të ndryshme të historisë, bënë më të mirën e mundshme për Kallarat dhe Shqipërinë!

(Shkëputur nga shënimet e z. Seit Jonuzaj “Kontributi dhe qëndresa e Kallaratis ndaj pushtuesve të huaj”)

Organizata e Gruas u krijua më 25 gusht të vitit 1943 në shtëpinë e patriotes Duze Bajramaj, biri i së cilës, Mumini, ishte një nga të parët kundërshtarë të vendosur të pushtimit fashist dhe dëshmor i parë i fshatit e i krahinës që bëri jetën fli për çlirimin e atdheut.

Gratë e Kallaratis përballuan me moral të lartë të gjitha operacionet ushtarake ndëshkimore të pushtuesve në krahinën tonë edhe kur ato shpesh ndodheshin vetëm me fëmijët nga që meshkujt ishin rreshtuar në formacione partizane apo ishin të angazhuar në aksione të ndryshme, si pjesëtarë të çetës territoriale.

— KALLARATI —

NË AKSIONET KOMBËTARE PËR RINDËRTIMIN E VENDIT TË SHKATËRRUAR NGA LUFTA, NGA VITI 1946 E NË VIJIM



NGA ÇIZË XHAFERAJ, ISH DREJTOR
I SHKOLLËS 8- VJEÇARE "MUMIN
SELAMI" KALLARAT

*Të nderuar lexues kallaratas,
por edhe më gjerë!*

Në këtë shkrim kthejmë sytë pas në vitet e para të Shqipërisë së lirë, kur vendi ynë, i dalë nga lufta shkatërrimtare, kishte nevojë të shëronte plagët dhe të hidhte themelet e një shteti të ri. Ishin vitet kur fjala aksion u bë simbol i rinisë dhe i popullit, ndërsa vullnetarizmi u kthye në mjetin kryesor për të rindërtuar vendin dhe për të ngritur veprat e para industriale e rrugore.

Në këtë lëvizje të madhe kombëtare nuk munguan bijtë dhe bijat e Kallaratit. Që prej vitit 1946 e në vijim, djem dhe vajza kallaratas iu përgjigjën thirrjes së atdheut, duke u bërë pjesë e brigadave të punës në aksione kombëtare. Ata shkuan aty ku hapeshin rrugë automobilistike e hekurudhore, ku ngriheshin digat dhe fabrikat e para, duke lënë për herë të parë prapa pragun e shtëpisë dhe duke u përballur me një jetë të re plot sakrificë, por edhe plot shpresë.

Por Kallaratasit, duke qenë në shkolla dhe në ushtri kanë marrë pjesë në shumë aksione të tjera, si në ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe, në fortifikimin e vendit. Në gjithë këto pjesëmarrje të kallaratasve në aksionet, nuk mund të harrojmë pjesëmarrjen e veçantë të skuadrës së ndërtimit të Kallaratit në eliminimin e pasojave të tërmetit të vitit 1979 në Shkodër.

Vajzat e para në aksione

Emrat e tyre mbeten gurë kujtese për fshatin: Belere Shakaj (Zhibaj), Asife Llanaj, Sulltana Memushaj, Bejaze Abazaj, e deri te nusët e reja si Nasube Goxhaj. Ato hodhën poshtë konceptet e ngushta patriarkale, morën kazmën e lopatën krah për krah me djemtë, duke treguar se gruaja shqiptare ishte e aftë të ndëronte një jetë të re. Ky ishte një hap i madh shoqëror: vajzat kallaratase, të rritura në fshat e me zakonet e tij, u bënë shembull i emancipimit dhe i formimit të njeriut të ri.

Të moshuarit dhe nënat e dëshmorëve

Aksionet nuk ishin vetëm të rinisë. Në brigada



punuan edhe nëna dëshmorësh, si Duze Bajrami, nëna e dëshmorit Mumin Selami dhe Hanko Toçi, nëna e dëshmorit Islam Janji, të cilat me lot në sy e zemër të tronditura nga humbja e djemëve të tyre e gjenin forcën të ndërtimit i atdheut për të cilin kishin dhënë jetën e tyre. Po ashtu morën pjesë edhe burra më në moshë si: Telo Duro, Abaz Hito, Veip Azemi, Muço Xheviti, Sulo Memushaj e shumë të tjerë, duke treguar se

puna për Shqipërinë nuk kishte moshë.

Vlera dhe mesazhi i aksioneve

Në brigadat vullnetare punonin krah për krah ata që lufta u kishte marrë të afërmit, ata që kishin qenë të përfshirë në lëvizjen nacionalçlirimtare, por edhe në fronte të ndryshme të punës në fshat. Aty u tejkaluan ndarjet e vjetra dhe u hodhën themelet e një fryme të re uniteti vëllazëror. Ishte një brez që, pa interes personal e pasqyrim, vetëm me

ushqimin e ditës, punonte për rindërtimin e vendit, Shqipërinë.

Të gjithë kallaratasit, ashtu si edhe aksionistët e tjerë, u kthyen të vlerësuar për punën e bërë, u kthyen me "S" në gjoks, vlerësimi moral i asaj kohe.

Kallaratasit dhanë shembullin e tyre

Kallaratasit pjesëmarrës në aksione treguan: Kurajë, duke lënë fshatin dhe duke u përballur me punë të panjohura; vullnet, duke sfiduar shiun, baltën e diellin përvëlues; atdhetari, duke vendosur interesin kombëtar mbi gjithçka; solidaritet, duke u bërë njësh me aksionistët nga të gjitha krahinat e Shqipërisë.

Një trashëgimi për t'u kujtuar

Aksionet kombëtare ishin shkolla e parë e punës dhe e edukimit për rininë shqiptare. Për Kallaratin, ato mbetën një kapitull krenarie, ku djemtë dhe vajzat e tij shkruan me djersë faqe të historisë së pasluftës. Nëpërmjet tyre, fshati ynë, i njohur për burrat trima në luftë, tregoi se kishte edhe bijë e bija që dinin të ndërtonin me paqe e punë.

Prandaj, sot, me mirënjohje, përkulemi para

Kallaratasit, duke qenë në shkolla dhe në ushtri kanë marrë pjesë në shumë aksione të tjera, si në ndërtimin e rrugës së Malësisë së Madhe, në fortifikimin e vendit. Në gjithë këto pjesëmarrje të kallaratasve në aksionet, nuk mund të harrojmë pjesëmarrjen e veçantë të skuadrës së ndërtimit të Kallaratit në eliminimin e pasojave të tërmetit të vitit 1979 në Shkodër.



kujtimit të tyre, duke i përmendur emrat dhe veprat që ndërtuan. Ata nuk ndërtuan vetëm hekurudha, fabrika e rrugë, por edhe karakterin e brezave që do të udhëhiqnin Shqipërinë për dekada.

Mirënjohje kontributit të tyre në rindërtimin e vendit!

Lista e pjesëmarrësve

Më poshtë janë emrat e kallarasve që morën pjesë në aksionet kombëtare, të ndarë sipas veprave dhe viteve:



Karabolli, Bejaze Abazaj

III. NË RRUGËN KUKËS – PESHKOPI – 1947

Hysni Tozaj, Sheqere Laçaj, Zoto Mataj, Faik Zhibaj, Selman Qejvani, Ymer Davaci, Selim Gollosi, Pano Qejvani, Belere Zhibaj, Xhelal Breshani

IV. NË HEKURUDHËN DURRËS – PEQIN – 1948

Dasho Memushaj, Duze Bajramaj, Hanko Toçaj, Ferik Tozaj, Vesel Hoxhaj, Sulo Hoxhaj, Sulo Nexhipi, Veip Azemi, Selim Gollosi, Bejaze Abazaj, Selman Qejvani, Lalo Hitaj, Lalo Qejvanaj, Taibe Habilaj, Izeime Qejvanaj, Kadaife Bejtaj, Sulltana Memushaj, Ferzilete Toçaj, Pullumb Qejvani, Zilo Davaci, Birçe Lelaj, Haxhi Gjoni, Hysni Tozaj, Ymer Davaci

V. NË HEKURUDHËN KASHAR – YZBERISHT – 1948

Dasho Memushaj, Sulo Hoxhaj, Selim Gollosi, Bejaze Abazaj, Lalo Hitaj, Lalo Qejvanaj, Sulltana Memushaj, Kadaife Bejtaj, Izeime Qejvanaj, Taibe Habilaj

VI. NË KOMBINATIN E TEKSTILEVE STALIN, TIRANË – 1949

Duze Bajramaj, Besim Kasëmi, Muço Xhevit, Salo Mataj, Veip Azemi, Abaz Hito, Sinan Hitaj



VII. NË HEKURUDHËN PEQIN – ELBASAN – 1949

Dasho Memushaj, Sulo Hoxhaj, Mevlan Habilaj, Xhemal Strati, Bejaze Abazaj, Sulltana Memushaj, Lalo Hitaj, Selim Gollosi, Duze Bajramaj, Telo Xhibi, Sulo Nexhipi, Veip Azemi, Razip Strati, Brahim Strati, Sami Karabolli, Lilo Abazi, Selman Qejvani, Abaz Dautaj, Taro Bejtaj, Pelivan Jonuzi, Ahmet Shakaj

VIII. NË KANALIN E MYZEQESË

Salo Mataj, Veip Azemi, Selim Gollosi, Sulo Hoxhaj, Haxhi Gjoni

IX. NË RRUGËN SHËNMËRI – KOLGEGAJ

Selim Gollosi, Selman Qejvani

X. NË NDËRTIMIN E FABRIKËS SË ÇIMENTOS NË VLORË – 1947

Sinan Hitaj, Nelo Gollosi, Myfit Shate, Abaz Dautaj, Bejkush Laçaj, Sulo Nexhipi, Veip Azemi, Zagoll Demiri, Razip Strati, Sali Memushaj, Xhixho Dautaj, Refo Jovani, Hiqmet Shakaj, Selman Qejvani, Selim Davaci, Nasip Tozaj

XI. NË MINIERËN E SELENICËS

Muslli Birçe, Besim Kasëmi, Pelivan Shakaj, Abaz Dautaj, Bejkush Laçaj, Besim Jonuzaj, Sali Memushaj, Xhemal Strati, Neki Rjepi

XII. NË HEKURUDHËN RROGOZHINË – LUSHNJË – 1967

Lefter Rib, Shamet Jonuzaj, Afërdita Memushaj, Namaz Tozaj, Vera Hysi, Drita Rib

XIII. NË HEKURUDHËN RROGOZHINË – FIER 1967

Njazi Xhaferaj, Refat Rjepi, Emin Qejvani, Lumturi Laçaj, Rabo Boçaj, Afërdita Breshanaj

XIV. NË HEKURUDHËN RROGOZHINË – FIER – 1968

Mine Breshani, Hane Shakaj, Pashako Mataj, Alidie Demiri, Zeqo Hoxhaj, Spiro Xhaferaj, Laver Gjonbrataj, Dudi Rib

XV. NË HEKURUDHËN LIBRAZHD – PËRRENJAS (20 tetor – 20 dhjetor) 1970.

Aferdita Breshanaj (Begaj), Vezire Xhaferaj, Platon Jonuzaj, Selam Jonuzaj

XVI. NË HEKURUDHËN LIBRAZHD – PËRRENJAS – 1971

Toliat Habilaj, Hiko Rjepaj, Spiro Xhaferaj, Burbuqe Hoxhaj, Natasha Laçaj

XVII. NË HEKURUDHËN HOTOLISHT – LIBRAZHD – 1971

Labika Mehmetaj, Natasha Laçaj, Hanko Strataj

XVIII. NË TARACAT E LUKOVËS – 1980

Bastri Gjonbrataj, Katina Rib, Hane Qejvani, Brahim Goxhi

XIX. NË AKSIONIN LOKAL LLAKATUND, VLORË

Abaz Dautaj, Besim Jonuzaj, Refo Jovani, Bejkush Laçaj, Hiqmet Shakaj, Lulo Dautaj, Miro Boçaj, Hurma Ribaj, Haxhikë Ribaj, Besnike Janjiaj, Selvi Memushaj, Sarta Tozaj, Salihe Tozaj, Nasip Tozaj, Pelivan Jonuzaj, Sami Karabolli, Xhixho Dautaj, Taro Bejta,j Hasife Habilaj, Nasipe Hysaj, Mexho Gollosi, Qejvan Qejvani, Bejka Qejvani, Ismet Qejvani, Sabo Qejvani, Neki Rjepi, Lale Gollosaj, Selman Qejvani.

Shënim:

Nëse ndonjë emër mungon, me ndihmën dhe kujtesën e lexuesve, kjo listë do të bëhet edhe më e plotë.

Të dashur lexues!

Ky pasqyrim i pjesëmarrjes së kallarasve në aksionet kombëtare tregon qartë se fshati ynë nuk dha vetëm luftëtarë për çlirimin e atdheut, por edhe punëtorë të palodhur për rindërtimin e tij. Ata, të rinj e të moshuar, burra e gra, vajza e nuse, lanë gjurmë në çdo cep të Shqipërisë, nga hekurudhat e para te kombinatet industriale, nga fabrikat e çimentos te kanalet bujqësore, nga minierat te tarracat e bregdetit.

Kjo është një trashëgimi që meriton të kujtohet dhe të nderohet ndër breza.



REPORTAZH PËR
TAKIMIN E BREZAVE –
NGA BESNIK GJONBRATAJ

Më 16 gusht 2025, Kallaratit u vesh me petkun e festës dhe të emocioneve. Në sheshin e fshatit, të zbukuruar me flamuj e drita, u mbledhën bashkëfshatarë nga Shqipëria dhe diaspora, miq e dashamirës, për të festuar "Takimin e Brezave" – një traditë që çdo vit e forcon lidhjen me rrënjët dhe ngjall krenarinë për vendlindjen. Takimi nisi me ekzekutimin e Himnit Kombëtar, të vetmin simbol që na bashkon të gjithëve, duke ngritur lart ndjenjën e përkatësisë dhe të bashkimit kombëtar. Më pas, në emër të Kryesisë së Shoqatës "Kallaratit", sekretari z. Hasan Mehmetaj përshëndeti të pranishmit.

Në fjalën e tij midis të tjerash u shpreh: "Ndihej i vlerësuar që në këtë takim brezash t'ju përshëndes në emër të Kryesisë së Shoqatës 'Kallaratit'. Mirë se erdhët në këtë ditë të shënuar që na bashkon si një familje e madhe kallaratase! Sot, zemrat tona rrahin njësoj, të mbushura me gëzim e mall, sepse ky takim është më shumë se një festë, është një rikthim tek rrënjët, tek kujtimet, tek njerëzit tanë..." Në vijim, ai përmendi nismat e vitit, si "Mbill edhe ti një pemë në vendlindje", piknikun pranveror në "Fshatin e Djegur", vizitat përkujtuese dhe projektin e radhës, botimin e librit "Historiku i Kallaratit", një pasuri shpirtërore për brezat që vijnë.

Në vijim z. Besnik Gjonbrataj lexoi mesazhin e përshëndetjes së kryetarit të shoqatës "Fushëbardhës", z. Nexhip Onjea, i cili përcolli urimet e tij të përzemërta: "Kallaratit ynë i shtrënjtë ka filluar të rilindë, të rritet e të bëhet më i bukur. Le të rritet "Rrapi i Fushëbardhës" si simbol i miqësisë sonë, i fshatrave tona të djegur, i dëshmorëve të vitit 1914 dhe i gjakut të derdhur në çdo epope lavdie.

Në shenjë respekti e dashurie, ju dërgojmë një tufë me trëndafila të bardhë, dhuratë simbolike për të gjithë të pranishmit. Rroftë miqësia jonë labe dhe u trashëgoftë në breza!" Ky gjest i veçantë u shoqërua me duartrokitje dhe emocione, duke forcuar lidhjet mes dy fshatrave që i bashkon historia, zakonet dhe sakrificat.

Në mesin e të pranishmëve spikati veterani 91-vjeçar, Abaz Dauti, ardhur nga Durrësi, i cili u prit me respekt dhe dashuri. Gjithashtu, emigrantë që kishin përshkuar mijëra kilometra për të qenë pjesë e kësaj mbrëmjeje, treguan se dashuria për vendlindjen nuk shuhet kurrë.

Mbrëmja mori dritë edhe më të madhe me praninë për herë të dytë të këngëtares së njohur

MË 16 GUSHT 2025, NË KALLARAT U ZHVILLUA "TAKIMI I BREZAVE"



Maya Aliçkaj dhe këngëtarit Elton Begaj, të cilët u pritën me mjaft dashuri e entuziazëm.

Kulmi i këngëve ishte kur Maya së bashkë me motrën e saj Dritën dhe stërnipin e Alim Delo Kallaratit, këndoi këngën "Alim Delo Kallaratit", duke ngjallur mall e emocione të fuqishme. Ky moment mbeti kulmi i festës, një

kujtim i paharruar për të gjithë.

Në atmosferën festive u festuan edhe dy ditëlindje vajzash, ku u hap shampanja dhe u nda torta, duke sjellë një ndjesi familjare e të ngrohtë.

Bizneset private shërbyen me kulturë dhe gatime tradicionale, duke plotësuar tablonë e

mikpritjes kallaratase. Në çdo tavolinë buçiti kënga labe, ndërsa entuziazmi shpërtheu në valle, ku të rinj e të moshuar u bashkuan me Mayën në një gëzim të përbashkët.

Stafi i Blu TV Vlorë ishte i pranishëm për të fiksuar çdo moment, duke bërë intervista me të moshuar, të rinj, fëmijë, vendas, emigrantë e miq të ardhur. Ditën e nesërme, publikimet në rrjetet sociale nga Shoqata "Kallaratit", Blu TV dhe pjesëmarrësit shpërndanë jehonën e këtij takimi në çdo cep të botës ku ka kallaratas e dashamirës të fshatit.

Prania e përfaqësuesve të Bashkisë dhe Njësisë Administrative Horë-Vranisht i dha edhe më shumë seriozitet aktivitetit. Takimi i Brezave në Kallarat, gusht 2025, ishte një dëshmi e gjallë se kur jemi bashkë, arrijmë të bëjmë gjëra të bukura dhe me vlerë. Shoqata "Kallaratit" ka treguar me veprat e saj se misioni i saj kryesor është bashkimi i kallarataseve, ruajtja e traditave dhe përcimi i tyre te brezat që vijnë.

Nismat e ndërmarra deri tani janë shembulli më i mirë se kur bashkohen mendimet, idetë, mudi dhe kontributi financiar, lindin vepra të prekshme e me rëndësi për komunitetin. Kjo mbrëmje na tregoi se potenciali ynë është i madh. Por, për ta çuar më përpara këtë traditë, na duhet që vit pas viti të shtojmë pjesëmarrjen, të sjellim më shumë të rinj, të përfshijmë më shumë emigrantë e miq të fshatit. Sa më shumë të jemi, aq më e fuqishme do të jetë kjo jehonë e bukur që na bashkon. Me këtë bindje, le ta presim takimin e brezave të vitit të ardhshëm edhe më të organizuar, edhe më të pasur në përmbajtje dhe edhe më të gjerë në pjesëmarrje. Kjo është mënyra më e mirë për të treguar se Kallaratit nuk është vetëm një vend, ai është një ndjenjë, një krenari dhe një trashëgimi që duhet ruajtur e çuar përpara brez pas brezi.





TAKIMIT TË BREZAVE I MUNGOI NJË NJERI I VEÇNTË, DORI DEMIRAJ

Kjo natë kishte gjithëcka të bukur brenda, por asaj i mungoi një figurë e dashur për të gjithë Dori Demiraj, njeriu që me karrocën e tij ishte gjithmonë i pranishëm në çdo aktivitet të fshatit dhe të shoqatës, që na priste e përcillte me buzëqeshje, që na dërgonte informacione dhe fotografi të shumta. Largimi i tij i parakohshëm, më pak se 6 muaj më parë, ka lënë një boshllëk të madh për familjen, për bashkëfshatarët dhe për gjithë Kallaratin. I përcjellim homazh jetës së tij dhe ai do të mbetet në kujtesën e gjithësecilit në çdo takim brezash dhe jo vetëm.


NA NDEROJNË NË TAKIMIN E BREZAVE NË KALLARAT TË ZGJEDHUR DHE PUNONJËS TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË SË HIMARËS. FALEMINDERIT QË U BËTË PJESË E GËZIMIT TONË SI FSHAT

KËNGA “ALIM DELO KALLARATI”

Kjo këngë u këndua nga motrat e Maya dhe Drita Aliçkaj, e cila pati shumë jehonë, pasi këtyre dy këngëtareve iu shtua edhe një nga stërnipit e Delo Kallarait, Elmaz Mehmetaj.

Në lidhje me këtë këngë dhe historinë për Alim Delo Kallaratin, Enver Strati në librin e tij “Historiku i Kallarait” shkruan: “Alim Delo Mehmeti (Kallarati) në vitet 1906–1908 ishte kaçak. Për t’u ruajtur nga turqit ishte strehuar në malin e Dukatit tek disa sharrëxhinj të pajtuar nga një i dukat me emrin Murat. Gjatë një sherri mes shokëve të tij dhe sharrëxhinjve, këta vrasin një nga kaçakët që ishte me Alimin, i cili, për hakmarrje vret dy sharrëxhinj dhe hyn kështu në hasmëri me Muratin. Ky i fundit detyrohej nga kanuni t’u merrte hakën sharrëxhinjve, që ishin nën mbrojtjen e tij, dhe vret Alimin. Por zinxhiri i vrasjeve nuk mbaroi me kaq. Edhe pse Murati që në të drejtën e tij, më 1943 vëllai i Alimit, Llano Delua, së bashku me Nebo Qejvani, vrasin një djalë nga fisi i Muratit”.


Këtë e tregon dhe kënga që i është kënduar Alimit:
*Atje në Lumë të Bardhë
Shkuan ca udhëtarë,
Gjetën një njeri të vvarë,
Alim Delo Kallaranë.
Alim Delo Kallarati
E kish porsitur i jati,
Djalë mos shko nga Dukati,
Se do të vrasë Murati,
Se s’i ka dalë inati,
Se inati s’i ka dalë
Për sharrëxhinjtë që ke vvarë .*





GËZUAR DITËLINDJEN, LORENA!

Më 16 gusht 2025, pikërisht në natën e takimit të brezave në Kallarat, Lorena Mehmetaj, ardhur nga Italia, festoi ditëlindjen e saj në vendlindjen e babait, Robert Mehmetaj. Atmosfera festive u gjallërua me shampanjë, torta dhe urime të përzemërta, duke e bërë këtë ditë një kujtim të paharruar për të dhe gjithë të pranishmit. Edhe ne i bashkohemi urimit me gjithë zemër: Edhe 100 vite të lumtura, shëndet e gëzime, Lorena!



ABAZ DAUTAJ – SHEMBULL I DASHURISË PËR VENDLINDJEN

Abaz Dautaj është një nga veteranët e nderuar të Kallaratit, aktualisht banues në Durrës, i cili nuk i mungon kurrë vendlindjes në asnjë aktivitet. Kohët e fundit e kemi parë jo vetëm në “Takimin e Brezave”, por edhe në “Piknikun Pranveror” në Fshatin e Djegur, gjithmonë i shoqëruar me djalin, nipërit, nuset e tyre dhe miqtë e familjes. Një rast i rrallë për t’u marrë shembull, sepse me praninë e tij ai përcjell mesazh bashkimi dhe dashurie për rrënjët.

Me shumë vëmendje ndoqa intervistën e tij dhënë në Blu TV, në natën e takimit të brezave më 16 gusht, ku spikasin disa detaje që mbeten në kujtesë. Me një thjeshtësi fisnike ai prezantohet: “Jam Abaz Miftar Dautaj”, duke treguar krenari për mbiemrin dhe trungun familjar. Prekëse ishte edhe shprehja e tij: “Ajo që më tërheq më shumë të vij në Kallarat është nëna, dhe nënë quaj vendlindjen”. Një krahasim me shumë kuptim, që tregon lidhjen shpirtërore me Kallarat. Po aq domethënëse mbetet thënia: “Brezat venë e vijnë, por vatani mbetet aty”, duke na kujtuar se vendlindja është e përhershme, ndërsa ne jemi vetëm udhëtarë të përkohshëm.



NJË FOTO E VECANTË

Kur artistët e mëdhenj dinë të respektojnë e vlerësojnë njerëzit e thjeshtë, ndoshta të varfër materialisht, por të pasur në shpirt dhe dashuri për artin, muzikën dhe këngën, atëherë arti fiton vlera të mëdha. Bravo Maya, për këtë foto të veçantë me Azizin dhe për zemrën që di të prekë njerëzit e zemrës!

FALEMINDERIT KËNGËTARJA E MADHE E MUZIKËS POPULLORE, MAYA ALIÇKAJ

Një falënderim të veçantë për këngëtares e madhe Maya Aliçkaj, e cila për herë të dytë shprehu dashurinë e saj për Kallaratin duke marrë pjesë në Takimin e Brezave. Me zërin e saj të mrekullueshëm, me elegancën dhe me të folurën e saj prej aktoreje, Maya na dhuroi çaste të paharrueshme emocionale.

Së bashku me këngëtarin Alket Begaj dhe orkestrën e saj fantastike, ajo e ktheu mbrëmjen në një festë të vërtetë artistike. Ashtu si edhe vitet e kaluara, prania e saj, bashkë me fëmijët e talentuar, i shtoi këtij takimi një bukuri dhe gjallëri të veçantë. Maya këtë herë nuk erdhi thjesht si një mike e fshatit tonë, por si një bijë e Kallaratis, që e ndjen veten pjesë të tij. Të këndoftë shpirti e zemra gjithmonë, o Maya! Në Kallarati do të jesh gjithmonë e mirëpritur!

MAYA ALIÇKAJ: Falenderime të përzemërta, për Kallaratin, për dashurinë dhe respektin! Do jem gjithmonë me ju!



FALËNDERIM I KRYESISË SË SHOQATËS “KALLARATI” PËR TAKIMIN E BREZAVE 2025

Të dashur bashkëfshatarë!

Ashtu siç ishte paralajmëruar prej muajsh, më 16 gusht 2025, në një atmosferë festive e emocionuese në Kallarati, u zhvillua me sukses “Takimi i Brezave”. Në përfundim të këtij aktiviteti, Kryesia e Shoqatës “Kallarati” falënderon të gjithë ata që u bënë pjesë dhe kontribuan për realizimin e tij: Të gjithë bashkëfshatarët: banorët vendas, të ardhurit nga qytetet e Shqipërisë dhe emigrantët tanë, veçanërisht të rinjtë dhe të rejtat që dëshmuuan dashurinë për vendlindjen dhe rrënjët e të parëve. Të moshuarit e nderuar, të pranishëm si gjithmonë, ku veçojmë veteranin Abaz Dautaj, pjesëmarrës i përhershëm me fëmijë, nipër e stërnipër. Këngëtares e madhe, mikeshën tonë, Maya Aliçkaj, që me zërin dhe elegancën e saj ndezi sheshin në qendër të fshatit. Stafin e Blu TV, për profesionalizmin dhe korrektësinë në pasqyrimin e shpejtë të aktivitetit në Blu TV dhe rrjete sociale. Birin e fshatit tonë, gazetarin Endri Goxhaj, që mori pjesë si gazetar në stafin e Blu TV, por edhe si ndërlidhës për realizimin e këtij bashkëpunimi.

Sponsorët e këngëtares, orkestrës dhe fonisë: Lavdosh Jonuzaj, Mirjan Ribaj, Ylli Breshanaj, Aranit Rjepaj, Shkëlqim Strati, Everest Rjepaj. Mbështetësit me kontribute të tjera: Lulëzim Xhaferaj, Luan Abaz Shakaj,

Evgjeni Besim Jonuzaj, Aleks Çize Ribaj,



Rezart Xhelo Tozaj, Endri Goxhaj, e të tjerë.

Bashkinë e Himarës, për mbështetjen financiare të një pjese të aktivitetit. Këshilltarët e Bashkisë Himarë, për praninë dhe nderimin me pjesëmarrje në darkën festive. Kryetaren e Njësisë Administrative Horë-Vranisht, znj. Elena Memushaj dhe kryetarin e Këshillit të Fshatit, z. Bashkim Davaci, për koordinimin me Bashkinë Himarë dhe masat e marra për pritjen e të ardhurve. Shoqatën “Fushëbardha” dhe kryetarin e saj z. Nexhip Onjea, për mesazhin dhe buqetën me trëndafila të bardhë, dhuruar pjesëmarrësve.

Degët e Shoqatës “Kallarati” në Tiranë e Athinë, në veçanti: Bako Xhaferaj e Arjanit Rjepaj (Tiranë)

Lavdosh Jonuzaj dhe Mirjan Ribaj (Athinë), të cilët ishin ndër nismëtarët dhe organizatorët kryesorë të këtij takimi. Faleminderit familjes së Robert Mehmetaj, që gëzimin e ditëlindjes së vajzës së tyre, Lorenës, e ndanë me të gjithë të pranishmit në Takimin e Brezave. Bizneset vendase: Në qendër: Ergesi Hoxhaj me familjen dhe Koçua i Lumit, për shërbimin cilësor e mikpritjen. Në hyrje-dalje të fshatit: Astrit Mataj dhe Valo Jonuzaj, që i dhanë ngjyrë pritjes me shërbimin e tyre të kulturuar.

Faleminderit nga zemra të gjithëve! Le të fillojmë që tani të mendojmë për takimin e ardhshëm vitin tjetër.



SI U ARRIT TË REALIZOHEJ PERLA FOLKLORIKE “JANINËS Ç’I PANË SYTË”



Nga Hiqmet Meçaj

Në vitin 1983, gjatë përgatitjeve për festivalin e Gjirokastrës, me kërkesë të Haxhi Dalipit, më shkëputën për një vit nga puna në arsim, natyrisht me pëlqimin tim si i apasionuar pas traditës folklorike.

I ramë kryq e tërthor gjithë zonës së Labërisë, si dhe pjesëve të ndryshme më të ulëta për të zhbiruar vlera të tjera që nuk ishin paraqitur më parë në Festalet e Gjirokastrës.

Duhet të sqaroj se ishte formuar një komision ku merrnin pjesë veç meje dhe Haxhiut edhe muzikantë të tjerë të qytetit. Disa ditë debatua për konceptimin e koncertit që do të përgatitnim. Muzikantët e tjerë veç nesh ngulmuam për spektakël të larmishëm kurse unë, sidomos, pas meje edhe Haxhiu, ngulmuam për zbulime të paeksponuara më parë, për të cilat unë isha i bindur se ekzistonin. Duke qenë se pala tjetër ngulte këmbë në konceptin e saj, unë deklarova se jepja dorëheqjen nga pjesëmarrja, sepse sipas meje isha i tepërt dhe nuk kisha çfarë të jepja si kontribut, kur merreshin pjesë të njohura, përgatiteshin këngëtarë dhe valltarë dhe vetëm kaq.

Haxhiu u shqetësua se donte të punonte me mua. Debatu shkoi deri në Komitetin e Partisë, te sekretari përkatës por edhe te ai i Parë, që ishte Enver Halili.

Na thirrën të dy palët dhe zuri vend koncepti ynë, që ishte edhe më i vështirë për tu realizuar. Tani një episod për të qeshur por edhe për të qarë. Shkuam tek Komiteti Ekzekutiv, takuam Kryetarin, i cili na priti mirë fillimisht. Por kur i thamë përse kishim shkuar, për t’i kërkuar një makinë ta përdornim rreth dy muaj në terren, përgjigja e tij ishte kjo: Ju po shkoni të mblidhni folklor apo jo. Folklori nuk mblidhet me makinë, po ju japim dy kuaj ose dy mushka të shikoni çfarë folklori do mblidhni.

Ikëm prej tij të ofenduar por edhe duke qeshur



kur mendonim se çfarë leshko e drejtonte Komitetin Ekzekutiv. Nuk u ankua tek Sekretari i Parë, sepse s’na pëlqenin telashet që mund të hapeshin.

U nisëm me mjete rrethore. Tani po ndaloj tek tema e mësipërme.

Pas shkuarjes në shumë zona, Tragjas, Dukat, Himarë, Pilur, Vranisht, etj, kaluam në zonën e Sevasterit. Aty grupi i Sevasterit na paraqiti dy materiale, njëri kishte si temë një sahat të vjetër muri të Enver Hoxhës, tjetri që mu duk shumë i veçantë dhe që ata na e shpjeguan si këngë vaji që këndohej burgjeve të kalasë së Gjirokastrës. Teksti e kishte titullin: “Janinë te rrapi falë”. Grupi i këngëtarëve nuk ishte i nivelit të lartë por i mirë megjithatë jo në atë masë sa ta paraqitnim atë këngë në Festival. Mbj mend mirë se kishim me vete një magnetofon të stërmadh me shirit dhe me atë e regjistruam. U larguam nga Sevasteri dhe shkuam në fshatin Vajzë që ishte aty pranë. Aty përgjegjësi i kulturës i zonës na paraqiti grupin folklorik i cili nuk kishte ndonjë vlerë të veçantë që kërkonim ne. Këngëtarët na u dukën më të veçantë se ata të Sevasterit. I thashë Haxhiut ta provonim këngën e Janinës me këtë grup. Ishte disi më mirë por jo në nivelin që duhej.

Kur u kthyem në Vlorë Feti Brahimi i Lapardhasë na prezantoi grupin e tij, disa prej këngëtarëve mua më mbetën në mendje. Disku-

tuam me Haxhiun që këtë këngë ta përgatiste ky grup dhe t’i dëgjonim. Teksti ishte po ai: “Janinë te rrapi falë, sjellin një zabit të vranë, Zenel Çelo Progonanë... etj”. Kur kënga u përsos dhe arriti formën e kryeveprës që është sot, për të kontrolluar pëlqyshmërinë tonë maksimale, ftuam Çesk Zadenë, Avni Mulën, etj. Edhe ata mbetën të mahnitur nga kënga dhe grupi dhe na përgëzuan për këtë vlerë të papërsëritshme folklorike që kishim gjetur dhe ngritur në nivele shumë të larta, kjo natyrisht edhe në sajë të këngëtarëve të grupit.

Historia nuk mbaron me kaq. Vajti lajmi në Gjirokastrë, ku Progonati pretendonte se kënga ishte e tyre nga që përmendej një trim nga Progonati. Dy Komitetet e Partisë, Gjirokastrë-Vlorë u angazhuan që ta zgjidhnin këtë gjë. Më kujtohet si tani që mua dhe Haxhiun na thirri Enver Halili, Sekretari i Parë, dhe kërkoi sqarime si është puna dhe si duhet zgjidhur. Haxhiu i tha Sekretarit të Parë me këtë punë merret Hiqmeti. Ai me dashamirësi më tha: “Hiqmet ma shpjego, është këngë e Vlorës apo e Gjirokastrës. Po të jetë e tyre le t’ua japim”. U gjenda i papërgatitur, megjithatë as vetë s’e kuptova që dola nga situata shumë mirë. I thashë: “Ky është teksti provizor me të cilin po bëjmë prova për të mos e ekspozuar këngën tërësisht parakohe. Tekstin origjinal e di unë dhe as Haxhiut nuk ia kam thënë”. “Po qe

kështu tha Sekretari i Parë, e zgjidh unë këtë punë, ju vazhdoni të qetë”.

Unë mbaja mend një varg të një kënge tjetër me Janinë por jo të gjithë tekstin. Shkova në bibliotekë dhe gërmoja tek këngët e qëndresës shqiptare antiturke, por edhe te ato të mbrojtjes së Janinës nga ushtarët shqiptarë dezertorë të ushtrisë turke pas shpalljes së Pavarësisë.

E gjeta këngën dhe që të mos ndodhte ajo që po ndodh sot për të mohuar mua dhe kontributin tim si dhe peshën e madhe psikologjike që më rëndonte mbi shpinë i vura një çelës sigurie që asnjëri s’e ka kuptuar deri më sot. Tani po sqaroj pak këtë peshën psikologjike. Jemi në vitin 1983 kur Mehmet Shehu me lidhje të ngushta me Vlorën, Kadri Hazbiu etj, ishin eliminuar. Një pjesë e mirë e këngëve tona qenë vajtim. U akuzova nën zë se po vija grupin folklorik të Vlorës të vajtonte për tradhëtarët e Partisë. Megjithatë kjo nuk më dekurajoi e as më trembi të vazhdoja.

Tani cili është kodi i fshehtë i këngës?

Vargu i fundit nuk ekziston gjëkund e kam shtuar unë.

Kënga flet për mbrojtjen e Janinës nga grekët, kurse vargu i fundit shtuar prej meje thotë: “Kur vranë Pashanë, i njohne”. Është një varg absurd që shërben si kod i fshehtë kundër atyre që duan të përvetësojnë punën intelektuale të të tjerëve”

ANDON BEGAJ

ZËRI I GJALLË I KËNGËS LABE

Andon Begaj, sa bolenas aq edhe kallaratas, është një nga marrësit më të mirë të këngës labe. Me zërin e tij të fuqishëm e melodioz, ai ruan dhe përcjell brez pas brezi traditën e polifonisë labe, duke e bërë të kumbojë fuqishëm e ëmbël në çdo skenë, festë e gëzim, si dhe në çdo trapez e tavolinë familjare e shoqërie, ku është i pranishëm.

Anëtar i grupit “Bogonica” të Kallaratit, grupit të Bolenës dhe i disa grupeve të tjera të Vlorës, Andoni është ndër ata këngëtarë që mbajnë gjallë këtë trashëgimi shpirtërore të pasur, duke i dhënë këngës emocione dhe ngjyrim të veçantë.

Në këtë foto, ai shfaqet me veshjen kombëtare karakteristike të Labërisë, duke mishëruar krenarinë dhe identitetin e këngëtarit të polifonisë labe.



TRUPI NË KURBET, MENDJA NË ATDHE

- Poezi nga Riza Memushaj -

Shoqata “Kallarati” përgëzon me respekt autorin Riza Memushaj për këtë poezi të shkruar me ndjenjë, ku malli për Kallaratin dhe Atdheun vjen i gjallë, i pastër dhe prekës. Vargje zemre që bashkojnë mërgimin me rrënjët dhe na kujtojnë se, kudo që jemi, Kallarati jeton brenda nesh.

TRUPI NË KURBET, MENDJA NË ATDHE

*Trupi në kurbet
Mëndja në Atdhe
Fizikisht këtu
Shpirtërisht atje.*

*Ku e nisa jetën
Edhe ku u rrita
Atje më rri mëndja
Përnatë e përdita.*

*Edhe pse atje
Nuk kam asnjë pronë
Mëndja prapë se prapë
Atje më qëndron.*

*Tridhjet e pesë vjet
Këtu në mërgim
Po në ëndërra shoh
Vetëm vendin tim.*

*Këtu kam familjen
Këtu ha e pi
Po këtu një ëndërr
Skam parë der tani.*

*Si ai zgalemi
Që shkon përmbi dete*



*Mëndja natë për natë
Tek linda më vete.*

*Ku i hapa sytë
Dhe dola në jetë
Gjysmë e zemrës time
Atje më ka mbet.*

*Ku pata shtëpinë
Që se kam më sot
Mëndja hergjele’
Atje më “kullot”.*

*Kujtoj nënë e babë
Dhe tërë farefis
Vëndet ku kam loz
Dhe ku kam
gjezdis.*

*Herë “lahem”te ngjilli
Aty poshtë shtëpisë
Dhe më pas “vapoj”
Te shtrati nën lis.*

*Më bëhet në ëndërr
Sikur “kaloj” lumin
Edhe më të dal
Opingat më humbin.*

*Nganjëherë shikoj
Sikur del nga shtrati
Edhe më rrëmben
Po më shpëton fati.*

*Herë si një dron
Mbi fshat fluturoj*

*Vëndet ku kam shkel
Nga lartë i vështroj.*

*“Takohem” për natë
Me shokët e mi
Dhe pse të moshuar
Më duken fëmijë.*

*Dhe ata që s’rrojnë
I gjej të “gjallë”
Si dikur të vegjël
Takohem me mall.*

*E kam pyetur veten
Kushedi sa herë
Kjo që më ndodh mua
Ndodh dhe me të tjerë!!*

KALLARATI ME HISTORI

- Poezi nga Xhelo Tozaj –

Vargjet e mëposhtme nuk janë thjesht vargje, janë kujtime, mall, dhimbje dhe dashuri për Kallaratin. Janë fjalë që nuk maten me rregulla letrare, por me rrahjet e zemrës së një biri që nuk e ka harruar kurrë vendlindjen e tij. Në çdo varg ndjehet historia, sakrificat, rrënjët dhe shpresa se, Kallarati do të jetojë gjithmonë, pavarësisht kohëve, largësive apo vështirësive. Janë vargje që na prekin, na bashkojnë dhe na kujtojnë se fshati ynë është pjesë e identitetit tonë.

Mirënjohje Xhelos për këtë dhuratë shpirtërore dhe për dashurinë e singertë që i ka falur Kallaratin.

- Nga administratori i fejsbukut –

KALLARATI ME HISTORI

*Kunjova i solli zi,
u vendos në Piligri,
ndërtoi fshat për bukuri,
gati me njëqind shtëpi.
Banjo brenda e havlli,
Bogonica si çati.*

Greku na bëri kërdi,

e dogji, e bëri hi.

Luftuan me trimëri,

pesë burra u bënë fli.

Mbetën muret për stoli,

lapidari për karshi,

na tregon histori.

Fshati zbriti në vërri,

krijuan vatan e shtëpi,

mëhalla edhe vëllazëri.

Lumi lezet për bukuri,

vadit arat për mrekulli.

Me dy qendra lezeti:

Morrza e Ubavi.

Po filloi lufta prapë,

heronj e dëshmorë në fshat,

e lanë vendin me gjak.

Simbol lapidari i lartë.

Kur erdhi pushteti i ri,

u bë organizimi për mrekulli,

punoj fshati në bashkësi,

mori një zhvillim të ri.

Shkolla, kulturë e infermieri,

u përgatitën kuadro të rinj,

sipas kërkesave në ekonomi,

në arsim e shëndetësi,

që sot kanë lënë histori.

Por erdhi një jetë ere,

si gjithë bota, edhe ne,

me një metodë të re,

lamë tokat e shtëpinë,

edhe morëm arratinë:

Greqinë e Italinë.

Lamë mbrapa pleqërinë,

i harruam ç'farë ndërtuan,

në gërmadha u transformuan,

qendrën e kanë shëmtuar.

Historia na ka kalit,

jemi popull që bëjmë dritë,

këtë e kemi treguar

me fshatrat që kemi rindërtuar,

kur hallet na kanë detyruar.

Edhe puna ka filluar,

me njerëz të kulturuar,

që nga Kina e larguar.

Bashkëfshatarët janë bashkuar,

për ndriçimin kanë ndihmuar,

vendin e kanë gjelbëruar.

Kostumet janë investuar,

qendra e zërit u siguria

nga një pasardhëse e kulturuar,

të atin për ta nderuar,

që fëmijët kish mësuar.

Bashkëfshatarë të nderuar,

nga do që shkoni e keni ndaluar,

mos harroni fshatin tuaj.

Ju që keni vatane,

mos i lini të bien fare,

se prindërit tuaj kanë kaluar

shumë halle.

Do ta mbyll këtë poezi, duke kujtuar dy vargje të një kënge të grupit të Kallarait: Po të shkosh

në Kallarati, të bën përshtypje vërtet: janë njerëz me edukatë, më mirë se në qytet. Kështu do ta dëshiroja unë. Këto nuk janë fjalë të një poeti, por fjalë zemre.

ME RASTIN E 111 VJETORIT TË DJEGJES SË FSHATIT TË KALLARATIT NGA ANDARTËT GREKË NË VITIN 1914

FSHATI I DJEGUR, Poezi nga Hiqmet Meçaj

Kallarait, fshatit të nënës dhe të babait, të cilin të gjithë pushtuesit e kanë djegur dhe bashkëfshatarët e mi e kanë ngritur prapë.

Ka vetëm mure,

ka vetëm hi,

dyer nuk ka.

Ku të trokas?

Ku të trokas?

Kujt t'i thërras?

Kujt t'i thërras?

Nën hi dhimbje e madhe,

dhimbje e madhe mbi hi.

Djegur ditët,

djegur netët,

djegur mëngjeset

dhe mbrëmjet djegur.

O, mos trokit,

o, mos kërko,

nën hi e mbi hi,

ditë e net djegur.

Po rri me djalin,

i mësoj të lexojë gërmadhat,

të kuptojë sa i shtrenjtë është bari

nën muret e djegura nga barbarët.

Rilindin mëngjeset,

rilindin mbrëmjet,

rilindin ditët,

rilindin netët.

Im bir kokën në frëngji e mbështet,

mbulohet nga bari i gjelbër.

TË TJERËT SHKRUAJNË PËR KALLARATIN

Në kuadrin e rubrikës “Kohëra që nuk kthehen, njerëz që nuk harrohen” me shumë kënaqësi mirëpritëm mesazhin e z. Engjëll Hasimaj nga Armeni, i cili dikur ka qenë mësues në Kallarat në vitet '70. Ai na dërgoi disa foto bardhë e zi nga Qafa e Ubavit, si edhe kujtime të çmuara nga jeta e tij si mësues dhe banor i përkohshëm i fshatit tonë.

E falënderojmë nga zemra Engjëllin për këto kujtime e dëshmi, që nuk janë vetëm të tijat, por tashmë bëhen pasuri e historisë së përbashkët të Kallaratit. Si shumë mësues të ardhur ndër vite, edhe

Engjëlli është pjesë e mozaikut të arsimit e jetës sonë shoqërore në Kallarat, një emër dhe një kujtesë që nuk harrohet.

Ja si shkruan ndërmjet të tjerash Engjëlli në kujtimet e tij: “Erdha në Kallarat më Janarin e vitit 1970. Në fillim m'u duk i vështirë, por me kalimin e kohës, Kallarati u bë për mua si një shtëpi e dytë. U ndava me shumë mall nga ai fshat, kur m'u dha mundësia të vazhdoja studimet e larta.

Por kujtimet nga ai vend i bukur, me njerëz të mirë e me natyrë që të frymëzonte, më kanë ndjekur gjithë jetën. Edhe sot,

pas shumë vitesh, kur kujtoj Kallarat, më rikthehen në mendje zërat e nxënësve, aroma e druve të djegur në oxhak, rënkimi i Shushicës, kënga e ndonjë çobani në mal, mikpritja e banorëve dhe qetësia e maleve që e rrethonin fshatin.

Mësuesi, thonë, lë gjurmë në mendjen e nxënësit, por ndodh shpesh që edhe nxënësit, fshati dhe jeta atje lënë gjurmë në shpirtin e mësuesit. Kështu ndodhi me mua dhe Kallaratin”. - Redaksia

Të plotë kujtimet e tij i gjeni më poshtë:

ËNGJËLL HASIMAJ

“KUJTIMET E MIA PËR KALLARATIN
SI MËSUES I MATEMATIKËS, POR
EDHE SI NJË BANOR I PËRKOHSHËM I TIJ”

Për motive politike më kishin kthyer nga shkolla dhe ika ushtar. Nga ushtria i shkrova një letër Nexhmije Hoxhës. Ajo, me që unë isha fitues olimpiadash matematike në shkallë kombëtare, u interesua dhe ishte quajtur gabim heqja ime nga shkolla, dhe ishte vendosur që në shtatorin e ardhshëm unë do të shkoja në universitet përsëri.

Në dhjetor 1969 u lirova nga ushtria dhe, mbas vitit të ri, fillova të punoja në kooperativë, sepse duhej ta kisha mirë me ata të fshatit, se do të më nxirrnin pengesa të tjera, por jo më si një i “internuar”, sepse kishte shkrirë akulli, ishte thyer “këmba e shejtanit”, siç thoshte babai im.

Një ditë më lajmërojnë të shkoja në Komitetin Ekzekutiv, tek shefi i arsimit, Veledin Abazi. Ishte data 12–15 janar 1970. Shkova dhe e takova në zyrë në katin e tretë. Mbasi më pyeti sa për njohje, më tha: “Komiteti Ekzekutiv ju ka emëruar mësues matematike – fizike në Kallarat. Ju keni qenë nxënës shumë i mirë në matematikë në shkollën e mesme dhe kemi besim që do të jeni një mësues shumë i mirë.”

– E di ku ndodhet Kallarati? – më pyeti.

– Jo, – i thashë, – kam dëgjuar këngën për Kallarat, Kuç dhe Bolenë, por nuk i di ku ndodhen. Nuk kam qenë më lart se nga Drashovica.

– Mirë, – më tha. – Kallarati ndodhet në rrugën Vlorë–Kuç, prandaj merre këtë autorizim për biletë, sepse zakonisht nuk gjen biletë në atë linjë. Autobusi nisat çdo ditë në orën 13:00. Sot nuk ikën dot, por nesër duhet të nisesh pa tjetër, sepse nxënësit kanë një muaj pa bërë matematikë, se mësuesi i matematikës ka shkuar ushtar.

Kur të shkosh në Kallarat do të zbresësh tek Qafa e Ubavit, sepse atje do të të presë kryetari i këshillit të fshatit Kallarat. Ata të kanë siguruar strehimin dhe krevatin, ti do të marrësh dyshek dhe mbulojë dhe vishu mirë, se atje bën ftohtë. Besoj se do ta gjesh me dëborë, – më tha. – Do të shkosh që tani të marrësh biletën.

Më vonë mora vesh se edhe Veledin Abazi ishte nga Pajameu, një lagje e Kuçit kufi me Kallarat. U ndava me të dhe u nisa për të blerë biletën dhe pastaj u nisa për në Armen të merrja rroba për të fjetur. Babai u gëzua shumë që unë u emërova mësues, por u mërziq që më kishin emëruar aq larg dhe ishte mesi i dimrit dhe unë nuk kisha veshje trupi për dimër. Kisha një xhakëtë dhe një triko pambuku, nuk kisha



asnjë triko leshi.

Më vonë, e shoqja e kushëririt tim më punoi një triko leshi golf, e cila ishte punuar shumë mirë dhe më mbante ngrohtë, por dhe më pëlqente, se golfet atëherë ishin në modë. Pallto të madhe apo pardesy nuk kisha pasur ndonjëherë. Një rrobaqepëse më përshtati një pallto të vëllait.

Nuk prita të nesërmen, sepse nuk kisha siguri se të nesërmen mund të veja në Vlorë para orës 13:00, prandaj mora një dyshek, një jorgan dhe një velenxë (batanije) dhe u nisa për në Vlorë. Gjeta për fat një makinë dhe mbërrita në Vlorë dhe atë natë fjeta tek halla ime, të cilët më pritën me dashuri e bujari.

Të nesërmen, në orën 13:00, hipa në autobus. Me që e kisha marrë biletën me autorizim, kisha një vend të preferuar, pas shoferit. Ishte ftohtë, por autobusi u mbush plot, mbi numrin e caktuar dhe u ngroh menjëherë.

Unë nuk e dija rrugën, kisha qenë deri në Drashovicë, kur shkoni në festën e Drashovicës. Fshati i Kallaratit gjendet në juglindje të Vlorës, rreth 50–60 km në vijë ajrore, kurse rruga automobilistike është shumë më e gjatë, rreth 65–70 km. Mbasi ngjitëm Qafën e Koçit dhe sa mbërritëm në Qishbardhë, rruga mori nga e djathta, tek Kallafeti, dhe kaluam mbi urën e Drashovicës dhe filluam rrugën për në Kotë e më tej, rrugë e panjohur për mua.

Sa kaluam urën, rruga mori në të djathtë dhe menjëherë të shfaqet lugina e Shushicës e rrethuar nga të dy anët me male të larta. Me mua ishte ulur si pasagjer një plak nga Kuçi. Pyeta pasagjerin e ulur me mua se ku ndodhej Kallarati. Ai më tregonte me radhë malet: Ja, ai mali më i lartë tutje në sfond është mali i lartë i Çikës dhe në vazhdim Bogonica. Përballë është Çipini i Bolenës. Atje mes këtyre maleve të larta është Kallarati.

Në hapësirë nga Drashovica dukej shumë larg, por rruga e bukur kalonte shumë këndshëm anës Shushicës dhe koha e udhëtimit kaloi shumë shpejt. Një që udhëton për herë të parë, si unë, kur sheh malet mbi kokë që fillojnë nga ura e Drashovicës, ka një ndjesi që e mbush me krenari që po futesh

në një zonë që në shekuj ka bërë histori. Banorët e këtyre anëve nuk janë përkulur nga asnjë pushtues e sundues.

Ishte 16–17 janari, mesi i dimrit, malet ishin zbardhur nga dëbora deri poshtë. Retë e ngarkuara me borë kishin zbritur deri mbi rrugë dhe sipër mbi kokë të qëndronin malet e lartë të ngarkuar me borën e bardhë. Por në verë kjo rrugë të mahnit me gjelbërimin që të rrethon gjatë gjithë rrugës.

Duke ecur kaluam me radhë Kotën, Gjormin, Lepenicën, Bratin – fshatra që m’i tregonte bashkudhëtari im. Në Brataj autobusi qëndronte 10–15 minuta, prandaj udhëtarët zbritën para një klubi të vogël. Zbrita dhe unë për në klub, por kishte shumë njerëz dhe ambienti ishte mbytës, ndaj dola jashtë, por ishte shumë ftohtë dhe ndjehej edhe më shumë, sepse brenda në autobus ishte shumë ngrohtë, ngaqë kishte shumë pasagjerë jashtë vendeve, që qëndronin në këmbë tek dera dhe hipnin e zbrisnin rrugës.

Kisha shumë ftohtë dhe hipa përsëri në autobus. Retë kishin zbritur fare mbi rrugë. Hipën dhe të tjerët dhe u nisëm. Arritëm në fushën e Tërbaçit, në Bramishje. Një lapidar në anë të rrugës. Pyes bashkudhëtarin. Më thotë: Këtu u krijua Brigada V, pjesëtar i së cilës kam qenë dhe unë, – më tha me një mburrje që dukej qartë.

Ruga merr kthesa dhe kalon Qafën e Elimit dhe shfaqet fusha e Vranishtit me Horën e lashtë. Fusha e Vranishtit është e madhe dhe në krye të saj është i vendosur fshati i Vranishtit, i shtrirë në prehërin e malit të Çikës, i ekspozuar nga lindja e diellit, i cili e përshëndet fshatin qysh herët në mëngjes.

Më vonë u bëra dhëndër në Vranisht. Në krye të Vranishtit, në këmbët e Çikës, gjendet shtëpia e të parëve të gruas time, Marjetës. Kam vajtur me Marjetën tek kjo shtëpi. Një shtëpi dykatëshe, por e rrënuar, ngaqë nuk interesohej njeri. Shtëpia kishte portë me hark, siç thonë fjalës: “kish ngjarë krushqia, pa ishte bërë”. Në atë shtëpi kishte bujtur Abdyl Frashëri dhe dy herë Ismail Qemali.

Kaluam Vranishtin dhe na dolën përpara disa shtëpi, disa rrepe dhe mbi ta një mal i lartë.

— Ky është Kallarati, – më tha plaku. – Mali përballë është Bogonica. Ja dhe shkolla jote.

Ishte një ndërtesë njëkatëshe në formën e shkronjës L.

— Ti do të zbresësh pak më lart, – më tha bashkëbiseduesi. – Kallarati ka dy qendra, këtu që quhet Morzë dhe tek Mapua e fshatit. Vendi tek Mapua e fshatit quhet Qafa e Ubavit, atje do të zbresësh.

Ecëm edhe pak dhe autobusi qëndroi dhe shoferi, që nga bisedat e kishte marrë vesh që isha mësuesi i ri i Kallaratit, thirri:

— Hajde mësues, se po të pret edhe drejtoresha e shkollës.

Shoferi i thirri një djali që po rrinte aty me drejtoreshën:

— Hajde, Osmën, ndihmoje mësuesin.

Unë zbrita. M’u afrua një vajzë dhe më tha:

— Ti je mësuesi?

Dhe më dha dorën e më pyeti:

— Ju jeni emëruar mësues në shkollën e Kallaratit?

— Po, – i thashë.

— Unë jam drejtoresha e shkollës, quhem Lumturi Godaj, – më tha ajo.

U afruan dhe dy a tre burra të tjerë që ishin aty dhe më takuan. Njëri ishte kryetari i këshillit popullor të fshatit, Muço Gjonbrati. Osmëni erdhi dhe mori rrobat e mia të fjetjes për t’i çuar tek shtëpia ku do banoja, që ishte përballë. Më thanë:



— Do të flesh tek ajo shtëpia atje, – duke ma treguar me dorë përballë. – Është shtëpia e mëmë Duzes, – më thanë.

— A ke dëgjuar për të?

— Jo, – u thashë.

— Është nëna e Heroit të Popullit, Mumin Selami, – më thanë.

— Po, për Mumin Selamin, heroin e popullit, dhe për katër heronjtë e Topanasë kam dëgjuar dhe lexuar, – u thashë.

Tani që shkruaj këto shënime, kujtoj kujdesin e madh që kishte ai sistem për trajtimin e mësuesve. Shefi i arsimit kishte lajmëruar dhe kryetari i pushtetit, në atë të ftohtë, priste mësuesin në rrugë. Drejtoresha, duke më thënë “natën e mirë dhe nesër do të shihemi në shkollë”, hipi në autobus dhe iku.

Njëri nga ata që ishin aty më tha:

— Ke dhe një shok tjetër në dhomë, është nënkryetari i kooperativës, e quajnë Zubi Jonuzi. Dikush më tha:

— Mbaje vetë çelësin e shtëpisë, mos ja lër Zybiut, sepse ai harron shumë dhe do të ngelesh jashtë ndonjë natë.

— Ore, mos ke frikë të flesh vetëm, – më tha një tjetër, – se je fusharak.

— Jo, mos kini merak, nuk kam frikë, – ju përgjigja.

Zybi Jonuzi, për të cilin do të flas në vijim, ishte shoku im i dhomës. Zybiu ishte me origjinë nga Kallarati, kishte mbaruar për doktor-veteriner në Tiranë dhe ishte emëruar në kooperativën Bolenë–Kallarati dhe aktualisht ishte dhe nënkryetar i kooperativës.

Bashkë me Osmënin u ngjitëm tek shtëpia ku do të banoja. Sapo errësohej kur ne mbërritëm tek shtëpia. Ishte një shtëpi njëkatëshe, e ngritur nga toka rreth 1–1.5 metra nga përpara, sepse dhe vendi kishte pjerrësi.

Ishin dy dhoma të mëdha, ndoshta 6×10 m, të ndara me një koridor të gjerë dhe përpara me disa shkallë dhe ballkon si një verandë, me dy kolona që mbanin mbulesën e ballkonit. Shtëpia ishte e mbuluar me pllaka guri, si kudo në Kallarati. Pra,

për kohën ishte një shtëpi komode. Përpara ishte një parcelë, që dikur kishte qenë tokë e mbjellë, por tani ishte një livadh i rrethuar nga të gjitha anët nga një pyll me shkurre. Nuk kishte asnjë pemë, veç një lis i lartë para verandës.

Njëra dhomë shërbente si magazinë patatesh për farë, kurse dhoma tjetër ishte dhoma e fjetjes sonë. Dhoma ishte e madhe. Në dhomën ku do të flija ishin dy susta: një mbante rrobat e Zybiut, kurse tek tjetra shtruam rrobat e mia. Ishte një oxhak i madh me dru lisi gati për zjarr. Me Osmënin ndezëm zjarrin, sepse ishte ftohtë. Dru lisi të thata dhe të trasha kishte plot në koridor dhe jashtë. Në dhomë ishte dhe një radio me bateri, që në atë kohë ishin të rralla. Osmëni e ndezi radion dhe duke u ngrohur, dëgjonim dhe radion.

Mbas pak erdhi dhe Zybiu. Dikush i kishte thënë për mua dhe erdhi menjëherë. U njohëm duke pyetur njëri-tjetrin për familjet, për shkollën. Prindërit e Zybiut rrinin në Vlorë. I ati dhe dy vëllezër ishin ushtarakë dhe një vëlla në një ambasadë.

Qysh në fillim, Zybiu më pëlqeu: ishte shumë i muhabetit dhe me shumë kulturë dhe me shumë njohuri, sidomos nga historia. Fisi i Zybiut në Kallarati ishte shumë i madh dhe i lidhur me luftën, por Zybiu, siç vura re, nuk manifestonte atë mburrjen e krahinës. Zybiu mbante një qen me emrin “Raxhi” dhe një mace, me të cilët u miqësova shpejt.

Të nesërmen, Osmëni më shoqëroi për në shkollë. Shkolla ishte larg, por mua më “hanin” këmbët për ecje. U takova me kolektivin e mësuesve. Kolektivi i mësuesve të shkollës, sapo vajta, më rrethoi me ngrohtësi dhe u miqësova shumë shpejt me gjithë mësuesit.

Drejtoresha më thirri në zyrë. Më pyeti sa për njohje me mua dhe më dha detyrat. Do të jepja matematikë dhe fizikë në shkollë dhe një klasë kujdestarie, klasën e shtatë. Shkolla ishte me nga një paralele, mësuesit ishin kryesisht vendas.

Ishin mësues atëherë: Çize Xhaferi dhe

bashkëshortja e tij Violeta Rjepaj (atëherë nuk ishin martuar, ishin të fejuar). Çizja jepte histori-geografi, kurse Violeta ishte mësuese në fillore. Bilal Breshani jepte gjuhë-letërsi, kurse Levzat Velaj nga Vlora jepte kimi-biologji. Mësuesit e tjerë ishin Burbuqe Qejvani, Proletare Habilaj dhe Hamit Muharremi, të cilët ishin mësues në fillore. Hamiti më kujtohet se e bënte mësimin mbasdite.

Çizja, Bilali dhe Levzati njihnin vëllanë tim, Kujtimin, dhe më pyetën çfarë e kisha dhe ku ishte me punë. Fillova me pasion punën. Mësimin e bëja me shumë pasion dhe përgatitesha me mjaft dëshirë. Nxënësit më respektonin, më dëgjonin me vëmendje dhe zbatonin me dëshirë çdo porosi timen.

Mbasditja ishte e vështirë për t’u kaluar. Në fshat nuk kishte asnjë lloj gjallërie dhe aktiviteti. Madje, aty nuk kishte ndonjë vend, si në Armen, ku të mblidhej rinia që të luanin futboll ose të zhvillohej ndonjë aktivitet tjetër. Të rinjtë ishin blegtorë dhe shtegtonin dimrit me bagëti, ndërsa beharit ishin në mal.

Vatra e kulturës ishte një dhomë e vjetër anës rrugës, por nuk frekuentohej dhe nuk kryente ndonjë funksion. Nuk kishte fushë futbollit.

Zura miqësi me Shaqo Hasanaj (nga Vranishti), shitës në MAPO-n e fshatit, që e kisha afër. Në MAPO merrja vezë apo prodhime të tjera blegtorale si gjalpë e djathë. Shaqua ishte njeri shumë dashamirës dhe kishte nevojë për shoqëri si dhe unë, dhe zumë menjëherë miqësi, si jabanxhinj që ishim të dy. Shaqua atëherë vazhdonte shkollën e mesme me korrespondencë në Vlorë. Mbasdite shkoja tek MAPO dhe i bëja konsultime Shaqos, dhe e mbyllnim konsultimin me ndonjë gotë konjak e me meze llokume. Më vonë erdhi shitës Gjolek Memushi nga fshati.

Shpesh venim me Zubiun tek nënë Zankua, halla e Zybiut, një plakë e urtë, fisnike dhe bujare që na priste me dashamirësi. Ajo jetonte me vajzën që ishte rrobaqepëse. Unë, meqë më “hanin duart” për punë dhe për ta ndihmuar nënë Zankon, një mbasdite në fund të vitit mësimor (qershor), i korra grurin në baçen e saj.

Shpesh të shtunave mbasdite dhe të dielave (e shtuna ishte ditë pune) dilja shëtitje gjatë rrugës automobilistike deri afër Kuçit, ose në kodrat përreth, ose nga pasarella kaloja matanë lumit dhe shëtisja nëpër pyll.

Një ditë në pyll matanë lumit pashë një godinë dykatëshe dhe me mur të punuar mirë, por siç dukej, ishte djegur gjatë luftës. Të jepte përshtypjen se pronari i saj kishte qenë dikushi. Kur pyeta, mora vesh se pronari i saj kishte qenë një mësues i vjetër, patriot me emër në krahinën e Vlorës, Meçan Selami (Qejvani) quhej, ishte babai i mësuese Burbuqes dhe vjehrrri i Sihat Tozaj, atëherë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Vlorës.

Më vonë lexova për Meçan Selamin: “Meçan Selami (Qejvani), pas mbarimit të shkollës fillore të Muradies në Vlorë, me porosi të Ismail Qemalit,

antifashist nacionalçlirimtar të Kallaratit deri në mbarim të luftës.

Një të dielë shkova tek fshati i vjetër, që ishte djegur nga grekët më 1914 dhe ishte braktisur nga banorët. Ky kishte qenë si një qytet i vogël, me shtëpitë të sistemuara afër njëra-tjetrës. Fshatarët, pas djegies, i kishin ndërtuar shtëpitë e reja më poshtë, por muret gjendeshin akoma aty.

Aty takova një plakë të mirë që ruante dhëntë (Petrova Abazaj). Më kujtohet ishte ditë e bukur prilli. Pashë një plakë që kulloste dhënë. Iu afrova plakës dhe e përshëndeta. I thashë:

— Jam mësues këtu në fshatin tuaj.

Plaka më pyeti nga isha dhe, kur mori vesh që isha nga Armeni, më tha:

— Edhe djali im është në Selenicë me punë.

E quajnë Lilo Abazi. E njeh?

mbasdite shpeshherë shkoja për të marrë bukë gruri, djathë, gjalpë apo dhe ndonjë kile mish. Shpeshherë mbasdite dhe të dielave shkonim me Levzatin, kolegun tim nga Vlora, për peshkim në lumin e Shushicës. Gjuanim troftë lumi, që fshatarët e quanin “pestrovë”.

Një ditë na përshëndeti një fshatar, por kolegu im, që kishte dy a tri vite mësues aty dhe i njihte mirë fshatarët, i qëndroi ftohtë. Kjo më ra në sy dhe, kur ai iku, ai më tha:

— Ti nuk e njeh, por ai është kulak dhe po të na shihte dikush që bisedonim me atë, na heqin nga arsimi dhe na çojnë të punojmë në kooperativë.

— Ka fëmijë në shkollë? – e pyeta.

— Po, – më tha, – e ka në klasën e tetë, dhe më tha emrin.

— Po të tregoj një histori me këtë kulakun,



dërgohet në Korfuz për shkollim të mëtejshëm, bashkë me Halim Xhelon, si nxënës të shkëlqyer. Të mëkuar me ndjenja atdhetare, bashkë me Halim Xhelon, më 1911 kthehen në atdhe dhe bashkohen me çetat e lirisë në luftë kundër pushtuesve turq. Merr pjesë në ngritjen e Flamurit dhe shpalljen e Pavarësisë më 1912 në Vlorë. Ishte një nga mësuesit e parë të shkollës shqipe në krahinë. Pjesëmarrës i qëndresës së kallarasave kundër bandave shoviniste greke më 1913–14. Më 1919 është midis atyre që rrëzuan flamurin italian dhe ngritën flamurin shqiptar në shkollën e Kallaratit, akt për të cilin u arrestua dhe u internua në Itali. Anëtar i shoqërisë “Shtizat e Qytetërimit” dhe “Mbrojtja shkollore”, që drejtohej nga shoku i tij Halim Xhelo. Në Luftën e Vlorës më 1920 ishte sekretar i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare” që kryesohej nga Osman Haxhiu, dhe delegat në Kongresin e Lushnjës. Pas vitit 1920 vijon mësimdhënien në shkollat e Bregdetit. Pjesëmarrës i Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Qershorit. Si antizogist, mori pjesë në Lëvizjen e Fierit më 1935. Më 1941–42 caktohet kryetar komune në Gostivar. Me fillimin e Luftës Antifashiste, kthehet në vendlindje. Zgjidhet kryetar i këshillit

Nga Levzati kisha dëgjuar fjalë shumë të mira për Lilon, por edhe më vonë dëgjova fjalë shumë të mira kur ai erdhi sekretar i Byrosë së Partisë së Punës në Armen. Në Armen, Lilua mbahet mend si sekretar dashamirës, që nuk nxitonte në luftën e klasave, siç kishin bërë vendasit.

Më vonë, kur unë shkova mësues në Selenicë dhe ai erdhi sekretar i komitetit të partisë aty, unë e njoha dhe vetë dhe ai kishte fëmijët nxënës në shkollën e mesme, ku unë jepja mësim. Ishte vërtet një njeri shumë i mirë.

Plaka m’u lut të pija dhallë nga një pagure metalike që kishte me vete dhe më pyeti se çfarë njerëzish kisha. Më vonë ajo plaka erdhi në Selenicë dhe dy mbesat e saja, vajzat e motrës së Lilos, i kisha nxënëse shumë të mira në gjimnazin e Selenicës.

Një ditë takova në Vlorë kushëririn tim, Asqeri Taullaraj, i cili punonte në ndërmarrjen e ndërtimit “Perlat Rexhepi” dhe ai vinte në Kuç, sepse ndërtonin një depo rezervash në mes të rrugës Kallarat–Kuç. Ata vinin çdo të hënë me makinën e tyre, prandaj dhe unë, kur shkoja në shtëpi, në Armen, shpeshherë vija të hënave me ata.

Ata kishin ndërtuar dhe një mensë dhe unë

– vazhdoi. – Ky kulaku kishte martuar vajzën dhe, me që këtu të huajt (jabanxhinjtë), sidomos mësuesit e huaj, i respektojnë shumë dhe kur kanë gëzime si p.sh. dasma, i ftojnë, por ai mua nuk mund të më ftonte, sepse ishte kulak, por edhe po të më ftonte, unë nuk mund të veja. Prandaj, ditën e hënë djali i tij më solli në një trastë rreth dy-tre kg mish tule viçi, mbështjellë me gazeta (queska atëherë nuk kishte).

Më tha: — Mësues, ke këtu ca mish, ma dha babai, sepse dje martuam motrën.

E urova për motrën dhe e mora mishin shpejt e shpejt, më tepër instinktivisht, që të mos më shikonin nxënësit e tjerë, se kush ma sillte atë torbë dhe që nuk dukej çfarë kishte brenda. Por më mbrapa më kapi frika se mos më kishin parë nxënësit që ishin në oborr dhe do të thoshin në shtëpi që mësuesi Levzati mori nga djali i kulakut një pako, ose vetë djali, apo vetë babai i tij, mund ta bënin bisedë në fshat. Prandaj vendosa t’ia kthej, por si t’ia ktheja, sepse do ta ofendoja.

Tërë kohën gjatë mësimit nuk e kisha mendjen tek mësimi, por mendoja si do t’i thosha, dhe së fundi gjeta zgjidhjen. Që të mos e ofendoja, do

t’i thosha:

— Nuk kam enë ku ta gatuaj.

Në fakt unë i kisha të gjitha enët e kuzhinës, sepse gatuaja ndonjë gjë edhe për djalin, sepse unë mbaja me vete djalin që ishte nxënës në fillore. Kështu bëra. E thirra dhe i thashë:

— Shumë faleminderit, thuaj babait, por unë nuk kam enë ku ta gatuaj. Nuk kam as tenxhere dhe as tigan, prandaj merre dhe çoje përsëri në shtëpi.

Djali e mori, por të nesërmen e solli përsëri mishin, të pjekur. Fisniku, në një mënyrë e tregon veten që është fisnik. Përsëri, djali të nesërmen erdhi tek dhoma ime dhe ma dha mishin të pjekur, mbështjellë me ca gazeta të bëra gjithë yndyrë, duke më thënë:

— Merre, mësues, se e poqi nëna.

E mora përsëri, por më hyri frika akoma më shumë. Më ra e papritur, sepse po ta kisha parë që larg, që të kisha kohë të mendoja, do t’ia kisha kthyer në moment, nuk do ta kisha futur fare në dhomë. Dhe atë ditë nuk e kisha fare mendjen tek mësimi. Thosha me vete:

— Do të thonë: mësuesi Levzati dy ditë rresht po shkëmben me djalin e kulakut sende të ndryshme. Do të lindnin dyshime.

Atëherë, nga sigurimi i shtetit, kur arrestohej ndonjë, qarkullonin legjenda duke hapur fjalë se në shtëpinë e atij që u arrestua, u gjet një radio marrës-dhënës me të cilën i arrestuari lidhej me spiunazhin amerikan.

Më hyri frika se mos më provokonin ose dikush na kishte ruajtur dhe vinin e kontrollonin në dhomë dhe ma gjenin mishin. Bëja mësimin, – tha Levzati, – por mendjen e kisha tek pakua e mishit. Si do t’ia bëja? T’ia ktheja nuk kisha si të justifikohesha, sepse nuk doja ta ofendoja atë njeri aq bujar, që sistemi i kishte vënë atë epitet denigrues e poshtërues, “kulak”.

Por, se dhe do të më shihnin që i dhashë përsëri djalit të kulakut një send! Mendjen nuk e kisha tek mësimi, kisha frikë të këshillohesha me ndonjë nga shokët. Kur nga ora e katërt shoh nga dritarja që në drejtim të drejtorisë po shkonte kryetari i këshillit (pushtetit), Xha Muçua, se kështu e quanin kryetarin e këshillit.

Ai ishte plagosur në hapjen e tunelit në Ujin e Ftohtë në Vlorë kur punonte në shoqërinë italiane “Celpa” diku nga viti 1939 dhe çalonte. Ishte një njeri që na respektonte shumë ne mësuesit. Sa herë që më takonte mua, më pyeste nëse kisha ndonjë problem, a kisha dru për ngrohje, etj.

Thashë me vete, – vazhdoi Levzati:

— E paskan lajmëruar kryetarin e këshillit dhe do të vijnë të më kontrollojnë në dhomë dhe do të ma gjejnë mishin dhe do të më diskreditojnë para popullit e nxënësve, duke më hequr edhe nga arsimi.

Thashë me vete:

— Më mirë po shkoj t’ju them vetë.

Sa ra zilja, shkova menjëherë në drejtori, ku ishin drejtoresha dhe kryetari dhe ju tregova historinë. Ju thashë:

— Si të bëj tani me mishin?

— Ku e ke mishin? – më tha kryetari.

— Në dhomë, – i thashë unë.

— Sille ta hamë, – tha kryetari, – se nuk bëjmë ndonjë gabim. Fundja e dëmtojmë ekonomikisht atë që t’a ka dhënë. Ne nuk bëjmë ndonjë gabim politik.

Dhe e hëngrën të dy mishin e viçit të pjekur. Mua dhe djalit tim na lanë gjysmën e mishit. Unë e djali im hëngrëm të qetë nga mishi i pjekur i viçit, që ai njeri fisnik e bujar na e solli pa ia kërkuar

njeri. Ai nuk e mori vesh kurrë që atë mish e kishin ngrënë së bashku me kryetarin e këshillit.

Dhe ky kolegu im ishte me përbërje të mirë politike, sepse babai i tij ishte internuar nga gjer-manët dhe kishte vdekur në internim.

— I thashë: edhe ti paske kaq frikë, që je familje dëshmori!

Jeta ime vazhdonte e qetë në Kallarat. Puna si mësues matematike-fizike më jepte shumë kënaqësi dhe e bëja me shumë pasion. Që ditët e para gjeta ngrohtësinë e kolektivit pedagogjik, i cili kishte mësues me arsimin përkatës dhe me përvojë pedagogjike. Ishin të rregullt, zbatonin disiplinën në punë me korrektësi, ishin shumë të thjeshtë e dashamirës, por edhe të përgatitur nga ana shkencore e pedagogjike.

Drejtoresha e shkollës, Lumturi Godaj ishte e qetë, e komunikueshme, kërkuese dhe me takt pedagogjik. Ajo nxiste përvojën e përparuar, të kritikonte me takt pa të bezdisur dhe ta vlerësonte punën.

Nxënësit ishin të vëmendshëm në orën e mësimit, respektonin mësuesin dhe rregulloren e shkollës. Vinin të rregullt me uniformën shkollore, të pastër, me detyra dhe libra. Jo vetëm në shkollë, por kudo në rrugë apo në shtëpi, të respektonin me shumë mirësjellje si nxënësit, ashtu edhe prindërit e tyre.

Kur shkonim në ndonjë nga shtëpitë e nxënësve për kontroll të zbatimit të orarit të studimit, gjenim tek prindërit e nxënësve një përkrahje, mbështetje dhe shumë dashamirësi.

Një të dielë të bukur maji, drejtoresha e shkollës, Lumturi Godaj, na ftoi për drekë në shtëpinë e saj, që gjendej afër Kallaratit, në mes të një pylli me drurë përralli dhe lisa të lartë, sa kaloje urën që ndante Kuçin me Kallaratin.

Kur vajtëm atje, na priti babai dhe nëna e Lumturisë. Babai i Lumturisë ishte i veshur me rroba karakteristike labe me tirqe, kurse nëna, një nënë labe e qetë. Babai i Lumturisë më pyeti më shumë mua, sepse unë vija për herë të parë.

Lumturia një drekë të tillë ua shtronte çdo vit mësuesve të shkollës. Ishte një familje fisnike dhe shumë bujare. Babai i Lumturisë u kënaq shumë kur mori vesh që unë isha nga Armeni. Ai më pyeti për babain dhe njerëzit e tjerë të familjes.

Dreka ishte me mish keci të pjekur në hell dhe meze me të brendshme, me djathë të njomë e gjizë të freskët, me byrekë e gjëra të tjera dhe në fund kos dele të ftohtë. Ky ishte një piknik i bukur që nuk harrohet. Më kujtoi ato festat që organizonte babai im për mësuesit tanë në Armen, duke i ftuar çdo vit për një darkë me mish të pjekur në hell.

Babai i Lumturisë mua më kushtoi shumë vëmendje, si i huaj. Dhe kur unë ika nga Kallarati, babai i Lumturisë pyeste gjithmonë për mua, “armenasin”. Madje, Levzati i tha vëllait tim, Shyqos:

— Vemi tek babai i Lumturisë.

Kur Shyqua i tha:

— Si do të vij, se unë nuk e njoh atë,

Levzati i tha:

— Engjëlli e ka mik, ai e ftonte gjithmonë Engjëllin.

Me që Zybiu ishte nga fshati, kishte shumë lidhje me fise të ndryshme dhe, nga puna që kishte, ishte shumë i lidhur me njerëzit dhe e ftonin shpesh në shtëpitë e tyre, dhe ai merrte shpesh edhe mua. Me që nuk kishte komunikacion, ne edhe të shtunave qëndronim aty në fshat dhe bashkë me Zybiun shkonim tek xha Shahin Jonuzi, të cilin Zybiu e kishte të tijin dhe e donte dhe e respektonte

shumë, sepse xha Shahini kishte mbaruar shkollë ushtarake në Itali.

Xha Shahini atëherë ishte lënë mënjanë, sepse kishte qenë oficer i mbretit Zog dhe nuk vlerësohej as për qëndresën që kishte bërë në Bestrovë së bashku me ushtarët e tij kundër fashistëve italianë, kur ata zbarkuan në Shqipëri, por, siç më thanë atëherë, ai nuk vlerësohej as për atë që së bashku me ushtarët e tij kishte braktisur frontin italo-grek, për të mos u vënë në shërbim të fashistëve. Por këto nuk ia vlerësonte njeri këtij patrioti dhe njeriu fisnik.

Më vonë, me ardhjen e demokracisë, mora vesh se figura e xha Shahin Jonuzit ishte rivlerësuar dhe m’u bë qejfi që tani qe bërë një rivlerësim e mirënjohje për aktin e tij heroik në mbrojtje të atdheut dhe qenka shkruar për veprimtarinë e tij patriotike në librin “Enciklopedia e Kurveleshit” dhe qenka vlerësuar me dekoratë.

Zybiu merrte dhe mua dhe shkonim tek xha Shahini dhe kalonim natën e shtunë dhe të dielë tek familja e tij. Na prisnin me shumë bujari dhe ne kënaqeshim, sepse shtëpia e tyre ishte një oaz gjelbërimi në mes të pyllit dhe larg nga fshati.

Vetë xha Shahini ishte një burrë i muhabetit dhe me kulturë, por dukej se ruhej shumë, sepse nuk kishte qejf të tregonte shumë për të kaluarën. Por edhe ai kënaqej me ne dhe shpesh ne loznim edhe me letra.

Zonja e tij Nënë Taibeja na kënaqte me gatimet e saj, por sidomos me mikpritjen e saj. Nuk shihje kurrë mërzitje në fytyrën e saj. Më kujtohet një djalë i xha Shahinit, e quanin Platon.

Mbas 50 vitesh, me gruan, me makinë po shkoja në Kuç dhe qëndrova tek ish-MAPO-ja dhe po i tregoja gruas time shtëpinë e mëmë Duzes, e cila ishte rrëzuar dhe mbuluar nga pylli. Kaloi një grua dhe na pyeti:

— Kë kërkoni?

I thashë:

— Nuk kërkojmë njeri, por unë kam qenë mësues këtu dhe kam fjetur tek shtëpia e mëmë Duzes.

Dhe, duke menduar se ajo mund të kishte qenë ndonjë ish-nxënëse ime, e pyeta:

— Po ju, e kujt jeni?

Më tha:

— Unë jam nga Bolena, por jam e martuar këtu në Kallarat

E pyeta:

— Me kë jeni martuar?

Më tha:

— Me Platon Jonuzin.

I thashë:

— Tek familja e Platonit kam qenë disa herë dhe kam shumë mbresa të mira edhe për xha Shahinin dhe për nënën e Platonit.

— Bëji shumë të fala Platonit, – i thashë.

Më tha:

— Kthehuni në shtëpi kur të vini nga Kuçi, sepse ja shtëpia jonë tek është, – dhe ma tregoi me dorë. – Do na bëhet shumë qejfi, – më tha.

Nuk u kthym, sepse erdhëm vonë dhe nuk donim t’i shqetësonim.

Të dielave tek ne vinte edhe Rami Memushaj, kushëriri i Zybiut, i cili atëherë ishte drejtor në shkollën e Vajzës. Ramiu kishte mbaruar shkëlqyer UT për gjuhë-letërsi dhe më vonë UT e tërhoqi për pedagog dhe aty Ramiu shkëlqeu, duke u afirmuar si një shkencëtar i gjuhësisë.

Zybiu e respektonte shumë dhe unë zura miqësi dhe, kur unë shkova student në Tiranë, e takoja shpesh dhe një herë më mori në shtëpi dhe më dha një fjalor voluminoz rusisht-anglisht.

Në përgjithësi, njerëzit në Kallarat ishin të dashur dhe bujarë. Të ftonin në shtëpi me pak raki, djathë e gjizë dhe pak qepë e hudhra të njoma dhe me muhabet të ëmbël.

Veç xha Muços, njihja edhe shumë të tjerë që edhe sot më kanë ngelur në mendje. Njihja Sulo Hoxhën, kunati i Lilos, i cili kishte dy vajza në shkollë, shumë të rregullta në mësim, por të tërhiqnin vëmendjen me veshjen shumë të pastër dhe ishin shumë të edukuara. Njihja Tahir Kondin, Namaz Tozaj, sekretarin e partisë Bejo Xhaferi, një burrë babaxhan dhe shumë dashamirës. Mbaj mend xha Izetin, babanë e Osmënit, kovaçi i fshatit. Sa herë që kaloja në rrugën Kallarat–Kuç, përballë kovaçanës, xha Izeti më përshëndeste me shumë dashamirësi dhe me respekt.

Një ditë, një nga fshatarët, duke parë që unë merrja në dhomë Osmënin, djalin e xha Izetit, më tha:

— Kij kujdes, sepse njëri djalë i xha Izetit

është i dënuar për arratisje.

Por Zybiu më tha:

— Mos ki frikë, nuk të thotë njëri gjë që merr Osmënin në shtëpi.

Osmëni e kishte shtëpinë shumë afër nesh, rrëzë një përroi. Aty rrotull shtëpisë sonë kullostë dhitë edhe Hajreja, nëna e Osmënit.

Osmëni na ftoi njëherë për darkë. Ishte freskët dhe nëna e Osmënit na gostiti fillimisht me nga një gotë me qumësht të ngrohtë, pastaj vazhdoi darka me kec të pjekur në hell dhe me raki. U kënaqëm deri vonë dhe ikëm në shtëpi, sepse e kishim shumë afër.

Shkoja me qejf në mëngjes në shkollë, megjithëse ishte larg. Kur vajta vitin e dytë, në shtator, gjatë rrugës ishte një baçë e kooperativës me fiq dhe këputja fiq të ndryshëm.

Një ditë, kur po kthehesha nga shkolla, kishte dalë një tufë me dhi që po kullosnin rreth rrugës dhe bashkë me ta ishte edhe një qen i zi që po rrinte i qetë dhe unë kalova pa problem. Por, kur u ktheva në darkë, qeni, kur më pa, u lëshua nga larg me një të lehur të frikshme dhe, kur më erdhi afër, më sulmoi, më kapi me dhëmbë për kofshe dhe ma shqeu pantallonën, por fatmirësisht nuk më lëndoi në trup.

Me zor erdhi çobani që ishte djalë i ri dhe e tërhoqi, por me shumë vështirësi. Ishte një qen i madh e shumë i egër. Çobani më kërkoi ndjesë, por unë isha trembur shumë. Arrita në shtëpi, i shqetësuar dhe i zemëruar. I tregova Zybiut ngjarjen. Ai u mërzit shumë dhe tha:

— Të nesërmen do ta zgjidhim këtë çështje.

Të nesërmen, Zybiu më mori me vete dhe shkuam në këshillin e fshatit dhe e paraqitëm ngjarjen. Kryetari i këshillit, xha Muçua e dëgjoji me vëmendje dhe u mërzit. Thirri menjëherë çobanin, i cili u justifikua duke thënë se nuk e kishte parë qenin që ishte me tufën.

— Pse nuk e lidh, – i tha kryetari, – pse e lë të lirë të sulmojë njerëzit?

Ai premtoi se do ta lidhte dhe nuk do ta linte më të lirë. Pas kësaj ngjarjeje, kalova për një kohë me frikë nga ai vend, por më pas e mora veten. Ky ishte rasti i vetëm kur u ndjeva realisht i rrezikuar në atë fshat.

Përveç ndonjë qeni të rrallë, gjithçka tjetër në Kallarat ishte e qetë, mikpritëse dhe mbresëlënëse. Fshati ishte në një luginë të bukur, rrethuar me male e pyje dhe me një rrjedhë të pastër uji që vinte nga mali.

Zybiu, që ishte si një mik, si një vëlla e

si një bashkëudhëtar në atë jetë mësuesie, më ndihmoi shumë. Ai kishte qenë në Kallarat që më përpara dhe kishte lidhje të shumta. Ai më prezantoi me shumë njerëz, më mësoi zakonet e fshatit, më ndihmoi në punët praktike, por më shumë më dha sigurinë e një njeriu që nuk të le vetëm asnjëherë.

Në mbrëmje, kur të gjithë ishin nëpër shtëpi, unë e Zybiu shpesh bisedonim për historinë, për politikën, për arsimin. Kishim të njëjtën dashuri për librin dhe e mbushnim kohën duke diskutuar. Ai kishte lexuar shumë dhe më tregonte ngjarje që nuk i dija. Ndonjëherë dëgjonim radion. Ndonjëherë përgatisnim ndonjë darkë të thjeshtë me ç’të kishte fshati: ndonjë vezë, ndonjë domate, djathë, ose një gotë raki.

Të dielave ishte dita e vetme që mund të merrje ndonjë letër apo gazetë, që vinin nga posta e Kuçit me ndonjë fëmijë. Me shumë vështirësi mund të gjeje gazetën “Zëri i Rinisë” apo “Zëri i Popullit”, që unë i lexoja me shumë interes për të qenë në korent me ngjarjet e kohës.

Një gëzim i madh ishte kur vinin inspektorët nga Vlora. Ato ditë shkolla lëvizte e gjitha, bëhej më e gjallë. Edhe nxënësit e ndienin këtë atmosferë të re. Inspektorët ishin njerëz të përgatitur, por edhe të thjeshtë dhe dashamirës. Mbanin shënime, shikonin ditarët, hynin në mësim, jepnin sugjerime, por gjithnjë me takt dhe respekt për punën e mësuesit.

Një herë erdhi në inspektim një inspektor i ri që nuk e njihja. Hyri në një orë matematike të klasës së shtatë. Ora shkoi shumë mirë. Nxënësit ishin aktivë, kishin mësuar, zgjidhnin ushtrime në dërrasë, ndërsa unë i udhëhiqja. Në fund, inspektori më përgëzoi dhe më tha:

— E ke pasion mësimdhënien, shihet që e bën me dëshirë.

Kjo më mbushi me gëzim. Në fakt, mësimdhënia ishte për mua një mision, jo vetëm një detyrë. Ishte një lidhje shpirtërore me nxënësit, me dijen dhe me të ardhmen.

Mbas 40 vitesh në demokraci kisha një problem me sahatin e dritave dhe vajta në një zyrë të elektrikut. Sa u futa në atë zyrë, aty zyrtari që te dera më tha: “Prit aty. Ti je mësues Engjëlli apo jo, që ke qenë mësues në Kallarat?”.

– Po, – i thashë.

– Dhe ti je Osmëni.

U takuam përzemërsisht. Ai më tha se banonte me familjen në Llakatund. Osmëni më pyeti përse kisha ardhë dhe ma zgjidhi problemin. Ngela shumë i kënaqur, por nuk e kam takuar më. Më thanë se në Llakatund ai kishte ndërtuar sera bujqësore.

Një natë na ftoi për darkë një familje kallaratase matanë lumit. Kaluam në pasarelë dhe vajtëm në mbrëmje. Aty erdhi nga Bolena dhe kryetari i këshillit të bashkuar të kooperativës, Hasan Jaçe Balili, babai i Nimet Balilit, atëherë pedagog e nëndrejtor në Shkollën e Partisë në Tiranë. Babai i Nimetit, siç tha vetë, kishte qenë në luftë në brigadën e I. Ai kishte shumë muhabet dhe shumë humor. Më erdhi shumë keq kur më vonë mora vesh që kishte humbur nipin, djalin e Nimetit, të cilin e mbanin ata në Bolenë si gjyshër. Ai kishte rënë në një humnerë në fshat.

Na kanë ftuar dhe kemi qenë edhe në shumë familje të tjera. E ruajta miqësinë me Zybiun. Dhe mbas disa vitesh, kur isha student në Tiranë, konsultova në matematikë një nipin e Zybiut, djalin e vëllait të madh të Zybiut, Seit Jonuzit, që ishte

oficer në Ministrinë e Mbrojtjes dhe më vonë në Vlorë ishte kryetar i veteranëve të Vlorës.

Gjatë kohës që unë isha në Kallarat erdhi një herë Estrada e Vlorës me trion e famshme vlonjate. Kooperativa u shtroi një darkë ku u ftova edhe unë. Në fund, unë mora për të fjetur aktorin e humorit Leka Kruta dhe një tjetër. Leka e vazhdonte humorin deri sa fjetëm natën vonë. Po kështu në Kallarat erdhën disa nga një kooperativë nga veriu, e cila ishte lidhur për shkëmbim përvoje me Kallarat dhe për ta u shtrua nga kooperativa një darkë ku isha ftuar edhe unë. Mua më ftonin si mësues jabanxhi, të cilët i respektonin shumë.

Në fund të vitit mësimor ishin provimet e lirim. Nxënësit u mobilizuan shumë për provimet, por edhe unë, duke zhvilluar pothuaj çdo ditë konsultime. Si përfaqësuese nga Seksioni i Arsimit erdhi një mësuese nga shkolla e Bolenës. Me sa mbaj mend, e quanin Lumturi Tartari. Nxënësit dolën shumë mirë, duke kënaqur mua dhe prindërit. Mbaruam vitin mësimor dhe u ktheva në Armen.

Në fund të gushtit më lajmëruan të shkoja mësues përsëri në Kallarat. Shkova përsëri në Kallarat. Ishte fundi gushtit. U paraqita në drejtorin dhe fillova të përgatisja planet dhe programet

dhe dy studentë të Fakultetit të Pyjeve të vitit të fundit: Rremzi Gaba nga Smokthina dhe Xhorxhi Hoxhara nga Vlora. Ne flnim në vilën e pyjores në Morzë të Kallaratit, e cila i kishte të gjitha komoditetet. Vila ishte një vilë alpine dhe me të gjitha komoditetet: me sobë kuzhine, krevate, susta, tavolina e karrike. Në ekipin tonë kishim aktivizuar edhe të rinj (nxënës), kryesisht nga Bolena. Meqë punën e kishim nga Bolena deri në Shur të Kuçit, drekën e hanim në mensën e Bolenës dhe pak herë në Kuç, sepse në Kallarat nuk kishte mensë. Matëm sasinë e drurëve, si dhe moshën e disa drurëve të cilët i shënonim me bojë të kuqe. Kishim harta të hollësishme ushtarake, ku përcaktoheshin edhe burimet dhe rrugët këmbësore. Në Pajame, një lagje e Kuçit kufi me Bolenën, atëherë ishin larguar familjet në Kuç dhe trojet me pemë ishin akoma. Kishte shumë fiq dhe arra. Kur ika nga aty për në Tiranë, mbusha një çantë sportive me arra. Kur mbaruam, atje ku buronte Shushica, unë dhe Engjëll Bimo premë një dru të trashë dhe e premë me faqe në të dy anët dhe shkruam inicialet tona dhe datën.

Disa herë vajtëm në Kuç, në Buronja dhe lart në fshat në klubin e fshatit, të cilin e gjenim plot. Një ditë u ngjitëm në malin mbi Bolenë, ishte fundi

për darkë dhe një ditë na mori për darkë edhe Rremziu. Rremziu e kishte shtëpinë aty afër Shushicës, ku derdhej lumi që rridhte nga Smokthina. U kënaqëm jo vetëm me mish të pjekur, por edhe me muhabet me babanë e Rremziut, që ishte një lab i zgjuar dhe muhabetçi.

Atë vit vajta një javë me vonesë në shkollë, por nuk pata problem, sepse e fillonim vitin me punë fizike dhe e bënim në një pallat që ngrihej për pedagogët. Kishim një teknik ndërtimi me origjinë nga Vlora, me të cilin zura shumë miqësi që e ruajta deri vonë. Kjo ishte hera e dytë në Kallarat dhe Bolenë. Por shkova edhe një herë të tretë.

PËR HERË TË TRETË NË KALLARAT

Përsëri gjatë pushimeve verore, kur isha student në universitet, një ditë takova Zybiun në Vlorë. Ai atëherë ishte transferuar në ndërmarrjen e peshkimit në Vlorë. Mbasi u çmallëm, më tha:

– Çfarë do të bësh tani beharit?

I thashë:

– Nuk kam ndonjë plan, por do punoj të marrë ndonjë lek që të blej ndonjë rrobë.

Ai më tha:

– Do të vish me mua të vemi në Kallarat dhe

– Të ruajt ai shok, or bir, që të merr me vete, qenka fisnik, por kij kujdes mos ftohesh, kij dhe kujdes nga nepërkat, sepse nëpër male ka shumë nepërka.

Mora disa ndërresa, nga dy libra dhe një palë letra bixhozi dhe erdha në Vlorë ku takova Zybiun dhe të nesërmen u nisëm e vajtëm në Kallarat. Atë natë vajtëm te xha Shahini. Xha Shahini dhe e shoqja u gëzuan shumë dhe na pritën me gëzim, si zemërbardhë që ishin. Pimë raki dhe biseduam deri natën vonë dhe të nesërmen herët, sa po gdhijej, u ngjitëm lart në Bogonicë. Më kujtohet se mbi shtëpinë e xha Shahinit ishte një burim me pak ujë, por shumë i ftohtë, i cili rridhte nga dy shkëmbinj. U ngjitëm malit lart dhe sa po dilte dielli dhe ne ishim në tufën e parë. Na pritën shumë mirë, u gëzuan, sidomos për Zybiun. Dhe në mbrëmje na therën një mish, por unë nuk haja shumë mish të majmë.

Të nesërmen, me një nga barinjtë shkova në baxho, te Gurra ku ishte një burim uji që shpërthente në atë lartësi. Përpara ishte një fushë e madhe që i thoshin Valth dhe ushtarakët tanë strategë kishin dhënë mendimin të bëhej fushë aviacioni dhe që do të kontrollonte gjithë Mesdheun! Baxhoxhiu më gostiti me djathë të njomë dhe kos dele dhe më dha me vete djathë e gjalpë të freskët. U çudita që në majë mali dilte gjithë ai burim uji.

Ditën e tretë kaluam në një tufë tjetër që ishte afër majës së Bogonicës. Atë ditë, më kujtohet, bëri shumë vapë dhe kishim shumë bezdi nga mizat, që bëhen shumë agresive kur është shumë vapë. Lozëm letra dhe në mbrëmje ata therën një mish dhe e poqën në hell nën dritën e hënës. Mbasi ndenjëm edhe këtu dy ditë, shkua në tufën e tretë dhe aty e kalonim kohën duke lozur letra. Në fund, letrat ua falëm barinjve që u gëzuan shumë, sepse me ato kalonin kohën dhe atëherë nuk gjeje letra, gjeje vetëm kur sillte ndonjë fshehurazi nga jashtë.

I them Zybiut:

– Nuk rrijmë më, sepse duhet të lahemi, prandaj nesër pa gdhirë duhet të zbresim në fshat dhe të hipim në autobusin e Kuçit.

U thamë atyre se nesër do të ikim, ata menjëherë therën një mish dhe e poqën dhe pothuaj na i dhanë neve të dyve. Pa u gdhirë u nisëm. Kur po gëdhihej, zbritëm në Kallarat. Shkua në shtëpinë e nënë Zankos, u lamë dhe dolëm në rrugë. Autobusi nuk kishte vend, por për fat na mori një skodë nga të druve. Erdhi në Vlorë vonë. Unë nuk ikja dot në Armen, prandaj i thashë Zybiut:

– Mere mishin të mos prishet, dhe unë vajta në hotel.

Me kalimin e kohës, Kallarati u bë për mua si një shtëpi e dytë. U ndava me shumë mall nga ai fshat, kur m'u dha mundësia të vazhdoja studimet e larta. Por kujtimet nga ai vend i bukur, me njerëz të mirë e me natyrë që të frymëzonte, më kanë ndjekur gjithë jetën.

Edhe sot, pas shumë vitesh, kur kujtoj Kallarat, më rikthehen në mendje zërat e nxënësve, aroma e druve të djegur në oxhak, rënkimi i Shushicës, kënga e ndonjë çobani në mal, mikpritja e banorëve dhe qetësia e maleve që e rrethonin fshatin.

Mësuesi, thonë, lë gjurmë në mendjen e nxënësit, por ndodh shpesh që edhe nxënësit, fshati dhe jeta atje lënë gjurmë në shpirtin e mësuesit.

Kështu ndodhi me mua dhe Kallarat.

Me respekt për të gjithë kallaratasit,

Nga: Engjëll Hasimaj,
ish mësues në Kallarat



shkollorë. Filloi edhe viti mësimor dhe kur kishin kaluar rreth 10-15 ditë më lajmëruan të shkoja në universitet.

PËR HERË TË DYTË NË KALLARAT

Mbas disa vitesh, kur isha student në Tiranë, u aktivizova gjatë verës në një ekip për mbarësh-timin e pyjeve nga Bolena në Kuç. Përgjegjësi i ekipit ishte Engjëll Bimo, i cili ishte kryeinxhinier në Drejtorinë e Pyjeve të Vlorës. Në ekip isha unë

i gushtit, por atë ditë ra një dëborë e lehtë. Atje ishte një fushë e vogël të cilën e mbillte kooperativa me thekër. Nga andej kalohej shumë lehtë në Kurveleshin e Sipërm, në Nivicë e Gusmar. Aty ishte një varr i njërit nga Kurveleshi i Sipërm, vrrarë nga bandat greke më 1914. Ky ishte me mbiemër Gumeni. Më tërhoqi vëmendjen, sepse ne atëherë kishim dy vëllezër në universitet me mbiemër Gumeni dhe nuk e dija nga ishin. Por kur pyeta, më thanë nga Gusmari.

Na morën dy nga nxënësit që kishim në punë

do të ngjitemi në malin e Bogonicës, të qëndrojmë ndonjë javë në stanet e bagëtive, sepse çobanët më kanë ftuar disa herë. Eja dhe ti, sepse do të kalojmë mirë.

– Mirë, – i thashë, – por do të vete nga dy-tri ditë në shtëpi.

Ashtu bëra. Shkova në Armen dhe u thashë vëllezërve dhe babait ku do të shkoja. Babait iu bë qejfi, sepse donte që unë të bëja një udhëtim turistik, por kishte dhe merak se mos sëmuresha. Më tha:

Faleminderit, Brahim Goxhaj!



Para disa ditësh, një kalimtar, duke udhëtuar drejt Qeparoit, ndaloi në Qafën e Ubavit, sepse i tërhoqi vëmendjen një pllakë përkujtimore kushtuar çeljes së shkollës së parë shoipe në Kallarat më 1916. Fatkeqësisht, shkronjat ishin zbehur nga koha dhe ishin bërë pothuajtë palexueshme.

Pas një thirrjeje që bëmë në faqen e Shoqatës "Kallarati" në Facebook, falë angazhimit të palodhur të Brahim Goxhajt, gjithmonë aktiv për vendlindjen, shkronjat u rishkruan dhe tashmë janë të lexueshme për çdo vizitor e kalimtar, përfshi edhe dashamirësin e Kallaratit, z. Selman Karaj nga Peza e Tiranës, i cili, në kthim nga pushimet, mund ta lexojë të plotë dedikimin e kësaj ngjarjeje historike.

Ky gjest i Brahimit është dëshmi e dashurisë për vendlindjen dhe kontributit për mbarëvajtjen e Shoqatës.

Faleminderit, Brahim Goxhaj!



TË NJOHIM TË RINJTË KALLARATAS

Valjon Myzafer Qejvani, një djalë i lindur e rritur në Kallarat, me rrënjë të forta atdhetare dhe ëndrra të mëdha. Pas shkollës në Amerikë, ku u arsimua si inxhinier mekanik, Valjon nuk u ndal me kaq. Vitet e punës dhe eksperiencat e fituar në General Motors Company (GM) në Detroit, Michigan USA si inxhinier mekanik i dhianë forcën, vizionin dhe guximin për të hapur kompaninë e tij private, "Stone works remodeling" (Punime gurë dhe rindërtime), duke u bërë shembull frymëzues për çdo të ri që beson te dijet dhe puna. Historia e Valjonit është dëshmi i gjallë se me përkushtim, dije dhe këmbëngulje, ëndrrat kthehen në realitet.

Suksese dhe mbarësi Valjonit në këtë rrugëtim të ri! Le të jetë një frymëzim për të gjithë brezin e ri Kallaratas kudo ku punon e jeton!



RIORGANIZIMI I RUBRIKAVE TË SHOQATËS “KALLARATI” NË FEJSBUK



Të dashur bashkëfshatarë, miq e ndjekës të faqes sonë!
Prej më shumë se 16 vitesh, faja jonë “Shoqata Kallarati”, ka qenë vendi ku takohemi të gjithë, kudo që ndodhemi. Me qindra ndjekës, jo vetëm nga Kallarati, por edhe nga çdo cep i Shqipërisë e nga diaspora, e kanë kthyer këtë faqe në dritaren më të dashur të lidhjes me vendlindjen

e origjinën e të parëve tanë, Kallaratin. Në këtë faqe kemi ndarë lajme të gëzueshme, kujtime të vjetra, histori të paharruara dhe mbi të gjitha dashurinë për fshatin tonë. Me kalimin e kohës, faja ka ecur përkrah zhvillimit të teknologjisë dhe të vetë Facebook-ut, por gjithmonë ka ruajtur të njëjtin mision: të na mbajë të bashkuar dhe afër njëri-tjetrit.

Për ta bërë këtë faqe edhe më të organizuar, kemi mendimin të rregullojmë disa nga rubrikat e mëparshme dhe të çelim disa të reja, për të cilat do të kërkohet mendimi i gjithkujt prej jush, që e dashuron dhe ka nostalgji për Kallaratin. Disa nga rubrikat që do të gjeni janë:

KAPITULLI I – HISTORIA DHE KUJTESA

1. Të njohim historinë e Kallarazit. – publikim i ngjarjeve dhe dokumenteve historike, nga lashtësia e deri në ditët tona, që të rinjtë të njohin rrënjët e tyre.
2. Figurat historike, arsimore, shkencore, kulturore, sportive, të jetës në fshat etj, të cilët kanë bërë emër në fushën e vetë dhe që kanë rritur vlerat e vendlindjes dhe ato kombëtare. – prezantim i personaliteteve kallaratase që me punën e tyre nderojnë fshatin në fusha të ndryshme.
3. Ngjarjet dhe figurat kombëtare. – përkujtim i momenteve madhore të historisë shqiptare dhe figurave që lanë gjurmë të pavdekshme.
4. Kohëra që nuk kthehen, njerëz që nuk harrohen. – foto bardhë e zi dhe kujtime të rralla nga jeta e dikurshme në fshat.
5. Përvjetorë të atyre që janë ndarë nga jeta. – përkujtime për njerëzit tanë të dashur që nuk jetojnë më, me dedikime nga familjarët e tyre.
6. Njoftime mortore. – lajmërim për ndarjen nga jeta të bashkëfshatarëve vetëm me kërkesë të familjes ose të afërmeve të tyre.
7. Nderim për Dëshmorët e Kallarazit. – rubrikë e përhershme për kujtimin e atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit, jo vetëm më 5 maj, por edhe në përvjetorët e lindjes ose të rënies së tyre.
8. Nënata dhe gjyshet tona. – kujtime dhe foto për figurat e tyre fisnike e të paharruara.

KAPITULLI II – ARSIMI, KULTURA, SPORTI DHE TRADITA

1. Arsimit në Kallarat. – histori, kujtime për mësuesit, nxënësit dhe rolin e shkollës në jetën e fshatit.
2. “Zëri i Bogonicës”. – këngët polifonike, grupet folklorike dhe traditat muzikore që na identifikojnë si fshat.
3. Rapsodët popullorë. – prezantim i rapsodëve popullorë që nëpërmjet vargjeve të tyre kanë lartësuar emrin e Kallarazit.
4. Krijimtaria letrare e artistike. – roman, poezi, prozë, piktura, vizatime dhe çdo krijim i autorëve kallaratase.
5. Të tjerët shkruajnë për Kallaratin. – artikuj, reportazhe dhe studime nga autorë të ndryshëm që kanë trajtuar fshatin tonë.
6. Gazeta “Kallarati”. – publikimi i çdo numri të ri të gazetës dhe i shkrimeve më përfaqësuese të saj.

KAPITULLI III – AKTUALITETI DHE JETA SHOQËRORE

1. Lajme nga Kallarati. – njoftime dhe ngjarje aktuale nga fshati, përditësime të shpejta nga terreni.

2. Urime dhe gëzime familjare. – urime për ditëlindje, martesë, lindje e çdo gëzim tjetër që na bashkon.
3. Falënderime. – shprehje mirënjohjeje për individë, familje e sponsorë që japin ndihmesë për fshatin dhe shoqatën.

KAPITULLI IV – RINIA, DIASPORA DHE BASHKËPUNIMI

1. Të rinjtë e talentuar brenda dhe jashtë vendit. – promovim i të rinjve që dallohen në mësim, art, sport apo fusha të tjera brenda e jashtë vendit.
2. Emigrantët kallaratase. – histori dhe rrëfime nga bashkëfshatarët tanë që jetojnë jashtë vendit, por mbajnë gjallë lidhjen me Kallaratin.
3. Biznesmenët kallaratase. – prezantim i bizneseve që drejtohen nga kallaratase brenda dhe jashtë Shqipërisë.
4. Bashkëpunimi me shoqatat e tjera. – aktivitete dhe nisma të përbashkëta që forcojnë lidhjet me fshatra dhe shoqata të tjera.

KAPITULLI V – RUBRIKA TË HAPURA

1. Propozime dhe ide të reja. – hapësirë ku çdo ndjekës mund të japë sugjerime dhe mendime për ta pasuruar faqen.

Kjo ndarje në kapituj e bën më të lehtë orientimin, ruan seriozitetin e faqes, dhe i jep çdo rubrikë një rol të qartë. Këto rubrika do të na ndihmojnë: Të ruajmë historinë dhe kujtesën e fshatit, të përcjellim kulturën dhe traditat tona, të mbajmë gjallë lidhjen midis brezave, dhe të promovojmë emrat e mirë të Kallarazit kudo në botë. Fejsbuku i shoqatës do të jetë për të informuar për zhvillimet e reja në Kallarat, për të kujtuar historinë e lashtë të tij, për t’u përshëndetur me njëri tjetrin, por në asnjë çast nuk do të shërbejë si arenë përplasjesh e ofendimesh, por për forcimin e unitetit mes nesh. Mendimi ndryshe është i mirëpritur, por brenda kufijve të etikës njerëzore. Shoqata është një organizim shoqëror i paanshëm, që nuk zëvendëson dhe nuk luan rolin e strukturave shtetërore apo të zgjedhurve vendorë e qendrorë, por ndihmuar që njerëzit të shprehin mendime të hapura për probleme që i përkasin gjithë komunitetit kallaratase. Ju ftojme të bëheni pjesë aktive e kësaj faqeje: dërgoni foto, shkrime dhe ide, të cilat do të pasurojnë këtë faqe të dashur dhe mjaft të vizituar, jo vetëm nga kallaratasit, por edhe nga miq e dashamirës të shumtë të fshatit tonë.

Administratori i Shoqatës Atdhetare & Kulturore Kallarati

Shoqata Atdhetare & Kulturore “Kallarati”
Kallarat, Vlorë, Albania
shoqata__kallarati__vlore

Dori! Gjashtë muaj pa ty, por gjithmonë mes nesh

Dori, sot bëhen 6 muaj që ti na mungon. Mungon për familjen tënde, për prindërit, për motrat, për vëllain, nipërit e mbesat; mungon për shokët e tu të shumtë, për të gjithë bashkëfshatarët e tu, sidomos në Kallarat, ku ishim mësuar të të shihnim çdo ditë, me karrocën tënde, duke dalë e hyrë hyrë për në shtëpi, gjithmonë i buzëqeshur dhe i fortë përballë sëmundjes.

Mungesa jote ndjehet edhe në Vlorë e kudo tjetër, ku miqësitë e tua ishin të shumta. Edhe pse jeta të vuri përballë sfidash, ti na dhuroje buzëqeshje dhe forcë, duke u bërë shembull për të gjithë.

Ishim mësuar të të kishim pranë në çdo aktivitet të Shoqatës së Kallarait, sidomos në Takimin e Brezave. Ti ishe jo vetëm pjesëmarrës i denjë, por edhe një korrespondent i çdo lajmi e ngjarjeje për bashkëfshatarët e tu.

Vetëm pesë ditë më parë u mbledhëm përsëri në Kallarat në Takimin e Brezave. Nata ishte e mbushur me gëzim, muzikë e mall, por i mungonte diçka e çmuar: mungonte prania e buzëqeshja jote, fjala e urtë me të cilën na prisje e përcillje gjithmonë.

Largimi yt i parakohshëm ka lënë një boshllëk të madh, jo vetëm për familjen tënde, por për gjithë fshatin. Ne festuam, por mungesën tënde e ndjemë thellë dhe do ta ndjemë gjithmonë.

Jemi të bindur se, edhe pse nuk ishte mes nesh, na shihje nga lart si një engjëll i mirë.

Ti, Dori, do të mbetesh gjithmonë në kujtesën tonë, në çdo aktivitet, në çdo takim brezash, sepse e deshe me shpirt vendlindjen tënde, Kallaratin.

Prehu në paqe, i qetë e ashtu buzagaz, si gjithmonë, o Dori ynë!



DEDIKIM ME RASTIN E 15 VJETORIT
TË NDARJES NGA JETA TË BABAIT
TONË TË SHTRENJTË,
GJOLEK MEMUSHAJ. - Nga fëmijët -

Erdhi përsëri gushti...
BABI, sa mall ndejmë për ty!
Sytë na mbushen me lot, sepse nuk mund
të të takojmë më...
15 vite kanë kaluar... por as koha nuk
e shuan dhimbjen dhe mungesën që na
le pas.
Loti dhe dashuria për ty nuk do të
shterojnë kurrë.
Na mungon fjala jote e ëmbël...
Dora jote që na përqaftonte...
Pritja jote në portë, kur na prisje me
zemër të hapur...
Babi i dashur, jemi krenarë që jemi
fëmijët e tu.
I palodhur, i drejtë, fjalë-mirë me të
gjithë – në familje, në punë, në shoqëri...
Të gjithë të kujtojnë me dashuri dhe
respekt të thellë.
Kujtimi yt është i gjallë në zemrat tona...
Dhe do të jetojë përgjithmonë.
U prehsh në paqe, babi ynë i shtrenjtë!
Nga fëmijët.



ENTE LA MEÇAJ -
DEDIKIM PËR HALLËN TIME,
YLVIE HASAN VELÇA (MEÇAJ)
ME RASTIN E NJË VJETORIT TË
NDARJES NGA JETA.

Një vit pa ty, hallë e dashur...
Një vit pa zërin tënd, pa fjalët e ngrohta,
pa buzëqeshjen që mbulohej shpesh nga
dhimbjet që të rëndonin shpirtin.
Ti ishe simbol i durimit dhe i përkushtimit,
një grua e fortë që përballove me dinjitet
plagët më të mëdha që mund t'i japë jeta.
E pavarësisht gjithçkaje, zemra jote mbeti e
bardhë dhe e ndritshme deri në fund të jetës.
Të kujtoj me mall e me mirënjohje për çdo
kujtim të bukur që më ke lënë.
Prehu në paqe, hallë Ylvie.
Kujtimi yt jeton në zemrën time.
Me dashuri dhe mall,
Entela



IN MEMORIAM

NDAHET NGA JETA FERIDE BRESHANAJ (HAXHIAJ)

Më 5 nëntor 2025 u nda nga jeta Feride Breshanaj (Haxhiaj), bashkëshortja e Gani Breshanaj (ndarë nga jeta në moshën 101 vjeçare), ish partizan i Brigadës 22 Sulmuese, nëna e 9 fëmijëve: Nako Breshanaj, Fatosh Breshanaj (ndarë nga jeta), Petro Breshanaj, Thëlleza Breshanaj, Eftali Breshanaj (ndarë nga jeta), Agron Breshanaj, Vera Breshanaj, Viktor Breshanaj dhe Trendelina Breshanaj.

Kryesia e shoqatës Kallarati u shpreh fëmijëve, nipërve e mbesave dhe gjithë të afërmve ngushëllimet më të sinqerta. Qoftë i paharruar kujtimi i saj! U prehtë në Paqe!

Më poshtë mund të lexoni një dedikim të djalit të saj, Petro Breshanaj, për nënën e tij të dashur:

“E dashura nëna ime, sot zemra ime është plot dhimbje dhe mirënjohje.
U prehë përgjithmonë, me atë qetësi që vetëm ata që kanë jetuar dhe dashur shumë mund ta kenë.
Në ditët e fundit e përsërisje shpesh, me një zë të butë dhe sy të mbushur me mall:
“Tani po shkoj tek ai.”
Të gjithë e dinim që flisje për babin



– për shokun e jetës tënde, për dashurinë që as vdekja nuk arriti ta ndajë.
Tani më në fund jeni sërisht bashkë, siç e dëshiroje që nga dita kur ai iku, gati tre vite më parë.
Ke qenë një nënë e mrekullueshme, e fortë si toka dhe e butë si buka që gatuj për ne.
Ke rritur nëntë fëmijë, një nga një, me

duart dhe me zemrën tënde, në një Shqipëri të varfër e të vështirë, ku shpesh nuk kishim asgjë, por ti gjithmonë gjeje mënyrën për të na dhënë gjithçka.
Mbah mend varfërinë e atyre viteve, por edhe dinjitetin tënd, forcën tënde të heshtur, aftësinë për ta kthyer lodhjen në dashuri.
Ke përballuar dhimbje që asnjë nënë nuk

duhet t'i njohë kurrë –
humbjen e vëllait tim Fatoshit dhe të motrës sime Eftalisë.
Dy plagë të thella që të shënuan, por nuk ta zhdukën kurrë butësinë.
I mbajte në zemër çdo ditë, dhe tani e di që edhe ata janë aty për të të pritur, bashkë me babin.
Ju imagjinoj të gjithëve së bashku – më në fund të ribashkuar si një familje që jeta e ndau, por përjetësia e bashkoi sërisht.
Do të më mungosh shumë, nëna ime...
Zëri yt, prania jote, këshillat e tua, mënyra jote e thjeshtë dhe e pafundme për të dashur.
Ke qenë forca jonë, shembulli ynë, rrënja jonë.
Gjithçka që jam, e kam prej teje dhe prej babit – prej jush që dhatë gjithçka, edhe kur nuk kishit asgjë.
Tani pusho e qetë, nëna ime.
Ke bërë shumë, ke dashur shumë, ke vuajtur shumë.
Tani është koha jote për paqe.
Përsëritet babin, Fatoshin dhe Eftalinë nga unë.
Do t'ju mbaj të gjithëve në zemër, çdo ditë të jetës sime”.
Me dashuri të pafundme,
Petro

Kryesia e Shoqatës “Kallarati” u shpreh gjithë familjeve dhe të afërme të tyre ngushëllimet më të thella e të sinqerta për humbjen e njerëzve të tyre të dashur. Qofshin të paharruar!

Ec ngado **KALLARATIN** *mos e harro!*



Kryeredaktor:
Lefter HYSAJ

Redaksia e Gazetës:

Anëtarë:

Prof. dr. Rami

MEMUSHAJ,

Hiqmet MEÇAJ,

Çize XHAFERAJ,

Eleni MEMUSHAJ,

Besnik GJONBRATAJ,

Riza MEMUSHAJ,

Selo QEJVANI.

Redaktor/korrektor:
Prof. Dr. Rami Memushaj

Graphic Designer:
A. Hysaj

Foto nga:
Besnik Gjonbrataj